



VENDIMI DHE GJETJET

Data e miratimit: 12 shkurt 2020

Numri i lëndës: 2016-12

U.F.

kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut, i mbledhur më 12 shkurt 2020, me përbërjen si në vijim:

Z. Guénaél METTRAUX, kryesues
Znj. Anna BEDNAREK, anëtare
Znj. Anna AUTIO, anëtare

Ndihmuar nga:
Z. Ronald HOOGHIEMSTRA, zyrtar ligjor

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP, të datës 4 shkurt 2008, Konceptin për llogaridhënien e EULEX-it për themelimin e Panelit për shqyrtimin e të drejtave të njeriut dhe të Rregullores së punës së Panelit, të datës 29 tetor 2009, të ndryshuar më 11 dhjetor 2019,

Pas shqyrtimeve, u vendos si në vijim:

I. PROCEDURAT PRANË PANELIT

1. Ankesa e kësaj lënde është regjistruar më 30 qershor 2016.
2. Përmes letrës së datës 1 korrik 2016, Paneli e informoi Misionin për regjistrimin e kësaj lënde në Panel.
3. Më 28 qershor 2017, Paneli kërkoi nga ky ankues dhe nga ankuesit e tjerë informata shtesë në lidhje me ankesat e tyre. Ankuesit fillimisht u përgjigjën përmes përfaqësuesit për familjet serbe nga Qendra Burimore për Personat e Zhdukur (QBPZh), OJQ në Prishtinë, duke thënë se ata nuk kishin informata të tjera në lidhje me ato raste.
4. Më 20 shtator dhe 17 tetor 2017, Paneli dërgoi dy kërkesa të tjera për informata shtesë përmes përfaqësuesit të QBPZh.

5. Më 20 tetor 2017, Paneli pranoi një përgjigje përmes përfaqësuesit të QBPZh me informata shtesë në lidhje me dy raste, përfshirë për rastin në fjalë.
6. Më 8 dhjetor 2017, Paneli i dërgoi deklaratën me fakte dhe pyetje Shefes së Misionit (ShM), EULEX Kosova, dhe e ftoi atë që të jepte përgjigje dhe vërejtje më shkrim mbi ankesat jo më vonë se 26 janar 2018.
7. Përmes letër së datës 17 janar 2019, Misionit prapë iu kërkuan përgjigje ndaj pyetjeve deri më datë 16 shkurt 2019.
8. Përmes letrës së datës 8 prill 2019, Misionit iu kërkua që të njoftojë se kur do të mund të jep përgjigje për pyetjet, dhe edhe një herë u ftua që të përgjigjet sa më parë që ishte e mundur.
9. Vërejtjet nga ShM erdhën më 14 qershor mars 2019, e më pas u dërguan tek ankuesit për vërejtje shtesë.
10. Më 5 korrik 2019, ankuesi dorëzoi vërejtje shtesë, të cilat u dërguan tek ShM për informim.
11. Më 11 shtator 2019, Paneli e shpalli ankesën të pranueshme në lidhje me nenet 2, 3, 8 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (<https://hrrp.eu/docs/decisions/2019-09-11%20Admissibility%20Decision%202016-12%20signed.pdf>).
12. Në atë vendim, Paneli ftoi palët që t'i shqyrtonin këto pyetje:

I. Për Misionin:

1. Çfarë hapi apo hapa janë ndërmarrë nga Misioni apo ndonjë nga organet e tij për ta hetuar këtë rast, nëse ishte ndërmarrë ndonjë?
2. Në paragrafin 24 më lartë, ceket si në vijim: Një bazë e të dhënave që i ishte dorëzuar EULEX-it nga UNMIK-u tregon se me sa duket në vitin 2003 kësaj zhdukjeje i ishte caktuar një numër i rastit nga Njësia e Policisë së UNMIK-ut për Persona të Zhdukur. Megjithatë, Misioni nuk ka marrë dokumente nga NjPZh në lidhje me këtë. A i ka kërkuar Misioni këto dokumente? Nëse po, kur dhe cila ishte përgjigja e UNMIK-ut për atë kërkesë?
3. A i është komunikuar ndonjë dokument për këtë rast që është marrë nga UNMIK-u familjarëve të të zhdukurit? Nëse nuk i është komunikuar, përse?
4. A ka bërë shkelje apo a ka kontribuar Misioni në shkeljen e të drejtave të ankuesit sipas neneve 2, 3, 8 dhe 13 të Konventës? Nëse po, në çfarë mënyre?

II. Për ankuesin:

1. Çfarë kontakti, nëse ka, keni pasur ju me Misionin EULEX Mision apo me përfaqësuesit e tij?
2. A jeni në dijeni për ndonjë përpjekje nga autoritetet vendase për ta hetuar këtë rast?

3. A ka bërë shkelje apo a ka kontribuar Misioni në shkeljen e të drejtave të ankuesit sipas neneve 2, 3, 8 dhe 13 të Konventës? Nëse po, në çfarë mënyre?
4. Cilat janë pasojat - personale, financiare, ligjore dhe emocionale - që lidhen me zhdukjen e të afërmit tuaj?

Palëve iu është kërkuar që t'i paraqesin përgjigjet e tyre, nëse kanë, për pyetjet si më sipër jo më vonë se deri më 11 nëntor 2019.

13. Më 9 tetor, Misioni kërkoi zgjatjen e afatit për dorëzimin e përgjigjeve ndaj pyetjeve të Panelit. Misionit iu zgjat afati për t'u përgjigjur deri më 11 dhjetor 2019.
14. Më nëntor 2019, ankuesi dërgoi komente shtesë si përgjigje ndaj kërkesave të Panelit.
15. Më 6 dhjetor 2019, Misioni i dorëzoi përgjigjet ndaj pyetjeve të Panelit.

II. FAKTET

16. Faktet e paraqitura nga ankuesi mund të përmbliidhen si më vazhdim.
17. Më 9 mars 2000 vëllai i ankuesit ishte kidnapuar. Për rrethë të fundit atë e kishte parë dhëndri i tij atë ditë diku rreth orës 10.15 jashtë shtëpisë së familjes së tij në pjesën veriore të Mitrovicës.
18. Po ashtu ka pretendime se ai ishte parë në një shtëpi tjetër të familjes në Vushtrri rreth po të njëjtës kohë "ku nga anëtarë të një shërbimi të sigurimit ai ishte futur me dhunë në një veturë të tipit Golf 2 me ngjyrë të zezë. Që atëherë më nuk është parë.
19. Për zhdukjen e tij janë lajmëruar Policia e UNMIK-ut në pjesën veriore të Mitrovicës, KFOR-i dhe pastaj EULEX Kosova. Ankuesi po ashtu thekson se për zhdukjen e tij ishin informuar edhe 'organizatat e tjera vendore dhe ndërkombëtare që merren me të drejtat dhe liritë e njeriut'. Prej parashtresave pasuese duket se ankuesi nuk ka patur kontakt të drejtpërdrejtë me EULEX-in, por supozon se informatat e dhëna tek institucionet e tjera do të ishin përcjellë tek EULEX-i (shih, para. 34, më poshtë). Sa i përket EULEX-it, në veçanti, ankuesi ka pohuar para Panelit se në një datë të pacaktuar, në kohën kur EULEX-i sapo kishte ardhur në Kosovë, gjatë një takimi të Shoqatës serbe për personat e zhdukur ai kishte biseduar me një pjesëtar të stafit të EULEX-it për familjarin e tij të zhdukur.
20. Ankuesi ka kërkuar që identiteti i tij të mos publikohet. Duke e pasur parasysh ndjeshmërinë e këtij rasti, Paneli është i qëndrimit që kërkesa e ankuesit për mospublikimin e identitetit të tij është e arsyeshme dhe e arsyetuar në bazë të rrethanave.

III. PARASHTRESAT E PALËVE

Ankuesi

21. Ankuesi pretendon se, gjatë ushtrimit të mandatit ekzekutiv të tij EULEX Kosova është dashur të hetonte zhdukjen e vëllait të tij dhe në mënyrë fajësuese nuk e ka bërë hetimin, duke shkelur kështu të drejtat themelore të tij.

Shefja e Misionit ("ShM")

22. Parashtresat e Misionit në lidhje me pranueshmërinë e këtij rasti janë pranuar në Panel më 14 qershor 2019. Disa prej këtyre parashtimeve janë relevante për konsiderimin e Panelit rreth meritave të këtij rasti andaj ato janë të reflektuara këtu.
23. Misioni së pari shpjegoi se në kuadër të dorëzimit të rasteve dhe dosjeve nga UNMIK-u tek EULEX-i në periudhën dhjetor 2008 – mars 2009, stafi i Misionit në atë që sot njihet si Instituti i Mjekësisë Ligjore (IML) mori një bazë të të dhënave që përmbante formularët e identifikimit të viktimave për personat e raportuar si të zhdukur gjatë dhe pas konfliktit. Ajo bazë e të dhënave ka përmbajtur një 'formular të identifikimit të viktimës' për familjarin e ankuesit. Në atë formular ceket se familjari i ankuesit (më tej në tekst: 'i zhdukuri') ishte parë për herë të fundit në Vushtrri më 9 mars 2000. Aty nuk ka informata lidhur me rrethanat e asaj zhdukjeje.
24. Në një bazë tjetër të të dhënave e dorëzuar në EULEX nga UNMIK-u shihet se, siç duket në vitin 2003, asaj zhdukjeje i ishte caktuar një numër rasti në Njësinë e Policisë së UNMIK-ut për Persona të Zhdukur (NjPZh). Megjithatë, Misioni nuk ka marrë dokumente të NjPZh në lidhje me të.
25. I vetmi dokument tjetër që EULEX ka marrë nga dorëzimi i rasteve nga UNMIK e që ka të bëjë në mënyrë specifike me këtë zhdukje është një kërkesë e panënshkruar e datës 18 dhjetor 2001 e parashtruar nga një avokat [siç supozohet në emër të familjes së të zhdukurit] e cila i drejtohej Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë ku kërkohej zgjerimi i një hetimi në proces e sipër kundër disa të dyshuarve me qëllim përfshirjen e hetimit në kidnapimin e pretenduar të të zhdukurit dhe personave të tjerë.
26. Misioni më tej parashtroi se Misioni nuk ka pasur dhëna që ankuesi i ka njoftuar njësitë policore dhe prokuroriale të Misionit në lidhje me zhdukjen e vëllait të tij. Misioni po ashtu theksoi se, sipas të dhënave që i ka, nuk ka pasur përfshirje të Misionit në lidhje me zhdukjen e familjarit të ankuesit.
27. Si përgjigje ndaj pyetjes së Panelit për atë pikë, Misioni ka dhënë një shpjegim të gjerë të procesit të ndërlikuar të marrjes, regjistrimit, kategorizimit, ruajtjes dhe rishikimit të dosjeve të pranura nga UNMIK-u. Misioni theksoi vështirësitë të përfshira dhe sfidën në paraqitur nga aspekti praktik dhe logjistik.
28. Misioni po ashtu specifikoi se Misioni nuk ka qenë në dijeni rreth ndonjë hetimi në proces e sipër të zhvilluar nga autoritetet e Kosovës për këtë rast dhe 'e ftoi ankuesin që këtë pyetje ta drejtonte te institucionet kompetente të Kosovës'.

29. Më 21 gusht 2019, Paneli ka kërkuar sqarim nga Misioni nëse ndonjë dosje lidhur me këtë rast i është bërë autoriteteve vendore të Kosovës në kohën e tranzicionit të Misionit në qershor 2018.
30. Përmes një poste elektronike të datës 23 gusht 2019, Misioni sqaroi çështjen si në vijim:
- “Formuari i identifikimit të viktimës për familjarin e U.F., si të gjithë ‘formularët e tjerë të identifikimit të viktimave’, ka qenë i qasshëm për autoritetet e vendit që nga fillimi i mandatit të EULEX-it. Sa i përket kërkesës së avokatit të cekur në faqen 2 të përgjigjeve nga EULEX-i të datës 14 qershor 2019, ai dokument i është bërë autoriteteve të vendit si pjesë e procesit të dorëzimit që është përmbyllur më 14 dhjetor 2018. Megjithatë, dëshirojmë të theksojmë se EULEX Kosova nuk e ka pranuar dokumentin në origjinal nga UNMIK-u por vetëm kopje të tij; Misioni nuk është në dijeni për vendndodhjen e dokumentit origjinal.”
31. Përveç kësaj që u cek më lartë, Misioni bëri parashtrime rreth meritës së këtij rasti më 6 dhjetor 2019.
32. Ndaj pyetjes lidhur me hapat, nëse kishte pasur ndonjë, që ishin ndërmarrë nga Misioni apo nga ndonjë prej organeve të tij për hetimin e këtij rasti, Misioni është përgjigjur se, sipas të dhënave që i ka, Misioni nuk e kishte hetuar këtë zhdukje. Ai shpjegoi se
- “[p]ër fat të keq, duke pasur parasysh burimet e kufizuara në dispozicion dhe afatin kohor të shkurtë të mandatit të tij, Misioni nuk ka pasur mundësi t’i hetojë të gjitha rastet e zhdukjeve dhe ka caktuar prioritete sa i përket shqyrtimit dhe vlerësimit të dosjeve të ‘krimeve të luftës’.”
33. Lidhur me pyetjen e dytë të Panelit (shih, *supra*, par. 12), Misioni është përgjigjur se nuk është dukur se EULEX-i kishte kërkuar dokumentacion nga UNMIK-u lidhur me këtë rast.
34. Paneli po ashtu ka pyetur Misionin nëse ndonjë prej dokumenteve që i kishte marrë nga UNMIK-u në lidhje me këtë rast i janë komunikuar të afërmeve të personit të zhdukur. Letra e Misionit nuk është tërësisht e qartë në lidhje me atë pikë, por nga përgjigja e tij duket se Misioni nuk i ka dhënë ato dokumente familjes së personit të zhdukur.
35. Ndaj pyetjes së Panelit nëse Misioni i ka shkelur të drejtat themelore të ankuesit, Misioni e ka ftuar Panelin që të merr parasysh parashtrimet e mëhershme të tij (të cekura dhe të përmbledhura më sipër). Misioni shtoi vërejtjet si në vijim:
- “EULEX nuk e konteston se ai ka pasur mandat për hetimin e zhdukjes së [...] dhe në lidhje me të, thekson se në vërejtjet e tij të datës 14 qershor 2019, nuk e ka kontestuar kompetencën *ratione materiae* të Panelit për këtë rast. Megjithatë, Misioni dëshiron të theksojë besimin e tij se një vlerësim i veprimit të EULEX-it sipas neneve 2, 3, 8 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në lidhje me këtë zhdukje konkrete nuk mund të mos e përfillë kontekstin dhe rrethanat në të cilat Misioni ka qenë i thirrur ta zbatojë mandatin e vet.

Siç është paraqitur tanimë, EULEX-i është përballur me sfida enorme që nga fillimi i mandatit të tij për shkak të gjendjes së keqe të dosjeve që i ka trashëguar nga UNMIK-u. Mes viteve 2008 dhe 2009 Misioni morri përsipër kontrollin mbi një numër shumë të madh të dokumenteve policore (rreth 800.000 faqe) të shpërndara nëpër dosje të paorganizuara. Shumë prej dosjeve kanë përmbajtur kopje të dokumenteve në vend të origjinaleve (shumë prej tyre të palexueshme), kishin mungesë të dokumenteve, dhe kanë përmçajtur dokumente me asgjë më shumë sesa informata të njëjta bazike që vazhdimisht përsëriteshin. Para dorëzimit në EULEX, informatat nga degët e ndryshme të policisë së UNMIK-ut që i referoheshin ngjarjeve të njëjta, përfshirë zhdukjet, nuk janë integruar apo bashkuar sistematikisht në dosje që do të mund të kërkoheshin me lehtësi; sistemet elektronike të menaxhimit të informatave që ishin dorëzuar ishin bazike dhe nuk ia kanë mundësuar Misionit që të grumbullonte të gjitha informatat në dispozicion për një rast. Në përgjithësi, ndonëse dokumentet e marra nga UNMIK-u kanë qenë materialisht në posedim të EULEX-it, fakti se ato nuk kanë mundur të kërkoheshin elektronikisht që nga fillimi i Misioni ka nënkuptuar se ato në fakt nuk kanë qenë të përdorshme, apo jo të përdorshme menjëherë.

Sipas 'Librit të kujtimeve të Kosovës' të Qendrës për të Drejtën Humanitare në Kosovë, më shumë se 13,000 persona, prej të cilëve 10,000 civilë, janë vrarë apo zhdukur gjatë periudhës 1998-2000. Shkalla e krimeve të kryera kërkon që pritshmëritë e mundësisë së një misioni të sundimit të ligjit si EULEX që të hetojë dhe ndjekë penalisht ato raste duhet të jenë 'reale' dhe proporcionale. Kjo pranohet nga praktika gjyqësore e konsoliduar e Panelit, si dhe në të drejtën përkatëse të Panelit Këshillëdhënës të UNMIK-ut për të Drejtat e Njeriut."

36. Misioni po ashtu pranon se zhdukjet me forcë janë shkelje të rënda të të drejtave të njeriut dhe se pretendimet për ndodhjen e akteve të tilla duhet të hetohen. Megjithatë, Misioni shtoi se

"kur kemi të bëjmë me vlerësimin nëse veprimet e tij kanë shkelur të drejtat e ankuesit, EULEX-i konteston idenë se dështimi për të hetuar një zhdukje që është bërë me forcë në vetvete mund të shpije në shkeljen e të drejtave të njeriut, kur një dështim i tillë materializohet në një kontekst të krimeve të shkallës së gjerë që përfshinë me mijëra viktima dhe kur është e qartë se nga asnjë autoritet hetimor nuk mund të pritet t'i zgjidhë të gjitha rastet që raportohen para tij."

37. Misioni theksoi në atë kontekst kufizimet e burimeve të veta, afatin kohor të kufizuar të Misionit dhe rrethanat e përgjithshme në të cilat EULEX-i ka operuar. Misioni po ashtu theksoi përfshirjen dhe kontributin e rëndësishëm të Institutit të Mjekësisë Ligjore në një numër të rasteve të zhdukjeve me forcë.
38. Misioni më tej pranoi se për t'i menaxhuar më mirë pritshmëritë dhe për të qenë më transparent, ai është dashur që të bëjë më shumë përpjekje komunikuese për t'i informuar të afërmit dhe publikun e gjerë rreth zbatimit të mandatit të tij si dhe rreth pengesave dhe kufizimeve.

39. Megjithatë, Misioni ka ardhur në përfundimin se në rastin aktual dhe duke pasur parasysh pengesat themelore të paraqitura,

“Misioni nuk beson se të drejtat e ankuesit janë shkelur.”

40. Në fund, Misioni ka nënvizuar përkushtimin e tij të vazhdueshëm për t'i ndihmuar autoriteteve të vendit, në veçanti përmes Institutit të Mjekësisë Ligjore, dhe përmes monitorimit të rasteve dhe trajtimeve.

Përgjigja nga ankuesi

41. Më 5 korrik 2019 ankuesi bëri parashtresa shtesë, të cilat u përcollën te Misioni për informim. 33. Në ato parashtresa, ankuesi në veçanti ka kundërshtuar parashtresën e Misionit se Misioni nuk ka qenë i informuar për çështjen. Në veçanti, ankuesi potencon faktin se ‘një raportim rreth një personi të zhdukur në territorin e Kosovës dhe Metohisë pas situatës paskonfliktit ka kërkuar urgjencë dhe efikasitet në veprimet e organeve të autorizuar, meqë çdo vonesë mund të kishte ndikim tek rezultatet e hetimeve’. Ankuesi shton se nëse Misioni nuk ka bërë regjistrimin dhe organizimin e regjistrave të veta në mënyrën e duhur, të tjerët nuk duhet të fajësohen për atë dështim dhe ai dështim nuk duhet të ndikojë tek meritat e ankesës së tij.

42. Ankuesi ka theksuar se nuk kishte informata në lidhje me materialin që UNMIK-u ka përcjellë tek EULEX-i, meqë asnjëra prej këtyre organizatave nuk e ka kontaktuar atë asnjëherë.

Ankuesi po ashtu ka thënë se përgjegjësia e Misionit për të zhvilluar hetime në asnjë mënyrë nuk mund të diktohet nga mënyra në të cilën UNMIK-u i ka emërtuar apo organizuar dosjet, dhe se ajo nuk mund të ndikojë te detyrimet e tij për të drejtat e njeriut:

“Nga momenti që ato dosje të rasteve i janë dorëzuar, Misioni ka qenë përgjegjës për shqyrtimin dhe hetimin efikas të tyre.”

Ankuesi nuk ka patur informata lidhur me hapat e ndërmarrë, nëse ka patur, nga Misioni për hetimin e këtij rasti. As bashkëpunimi i familjarëve nuk është kërkuar dhe ankuesi nuk është në dijeni për ndonjë përpjekje të bërë për hetimin e këtij rasti. Familjes nuk i është dhënë asnjë dokument në lidhje me rastin. Ankuesi shton si në vazhdim:

“Fakti se autoritetet, kompetente për zhvillimin e hetimeve për zhdukjen e [edituar nga Paneli], vazhdimisht janë ndërruar njëra pas tjetrës, në asnjë mënyrë nuk mund të jetë arsye për sjellje pasive/mosveprim nga ana e autoriteteve, e as t'i vihet barrë familjes së personit të zhdukur. Autoritetet kanë qenë përgjegjëse për të vepruar në lidhje me personin e raportuar si të zhdukur, për të bërë kërkime dhe hetime për atë rast, për të bërë hetime të duhura, për ta përfshirë familjen në procedura dhe për të raportuar rreth veprimeve të ndërmarra. Kjo në rastin tonë, përsërisim, nuk është bërë asnjëherë.”

Si përgjigje ndaj parashtresës së Misionit se ankuesi nuk i ka paraqitur argumentet juridike në lidhje me përgjegjësinë, ankuesi thekson si në vazhdim:

“Ajo që familja [edituar nga Paneli] pret është çjetja e [viktimës – edituar nga Paneli] që u zhduk në rrethana kërcënuese për jetën, gjë që familja ia kishte besuar autoriteteve kompetente. Megjithatë, arsyetimi që ankesa “përfshinë vetëm numra të neneve që pretendohet se janë shkelur dhe” tregon se si Misioni e konsideron Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut dhe familjen e viktimës. Po ashtu, në çfarë baze konkludon se ato nene dhe instrumentet ndërkombëtare relevante “pretendohet” se janë shkelur, nëse familja nuk e di nëse është bërë ndonjë hetim.

Sa i përket referimit të [Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut] rastit Varnava et al kundër Turqisë dhe renditjes së argumenteve të pabazuara që i referohen vendimit të përmendur, ne duhet të themi se interpretimi i këtij vendimi është absolutisht i pavlefshëm për rastin nr. 2016-12, U.F. kundër EULEX-it.

Së pari, të drejtat të cilave ankuesi i është referuar janë në mesin e parimeve, të drejtave dhe lirive themelore, të parapara dhe të garantuara me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Së dyti, prokurorët e EULEX-it janë të mandatuar që të hetojnë shkeljen e të drejtave të referuara nga ankuesi pavarësisht veprimeve të ankuesve, apo të referuara nga ta si “vonesë e panevojshme”. Së treti, një hetim gjithëpërfshirës dhe efektiv është i rëndësishëm për krijimin e ndjenjës së llogaridhënies dhe të kujdesit për sundimin e ligjit në çdo shoqëri që është në situatë pas ndonjë konflikti, sepse përgjegjësia duhet të jetë shoqërisë si tërësi, e jo vetëm e atyre të prekur në mënyrë të drejtpërdrejtë.

Jua përkujtoj se ky rast ka të bëjë me një person të përkatësisë kombëtare serbe, i zhdukur në rrethana kërcënuese për jetën në një mjedis etnikisht të pastër, i banuar pas luftës nga shqiptarë, dhe se ne dyshojmë se ai është vrarë, se familja i ka ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme sa i përket raportimit të të zhdukurit tek autoritetet kompetente, se familja asnjëherë nuk është përfshirë në procedurat parahetimore/hetimore nga ana e autoriteteve, dhe se familja dyshon që ky rast asnjëherë nuk është hetuar në mënyrë efektive. Nuk është e dukshme që në mungesë të çdo informate nga UNMIK-u dhe EULEX-i t'i vihet viktimës dhe familjes së viktimës nocioni i “vonesës së panevojshme”, kur kemi parasysh se familja asnjëherë nuk është informuar rreth rezultateve të hetimeve, andaj në rastin specifik ne nuk mund të flasim për “mosinteresim”, duke pasur parasysh se zhdukja e personit është raportuar tek të gjitha institucionet, ankesa është dorëzuar në qershor 2016, kur familja është informuar tek në vitin 2016 se hetimet nuk janë kryer në mënyrë efektive (shih Brunner kundër Turqisë (Vendimi nr. 10/10; Varnava et al kundër Turqisë (GC), si më lartë, §157).”

Ankuesi më pastaj ka shtuar si në vijim në lidhje me përcjelljen e informatave rreth këtij rasti nga një organizatë tek një tjetër:

“Theksojmë se familja [e edituar nga Paneli] nuk ka pasur për qëllim ta paraqesë rastin në gjykatën në Strasburg, por ka pritur që hetimet do të ndërmerreshin, se [viktima – e edituar nga Paneli] do të gjendej i gjallë apo i vdekur, se ajo do të mësonte se si është vrarë, kush e kishte vrarë, dhe do të mësonte për vendndodhjen e tij [mbetjeve mortore të tij], dhe jo raportin mes UNMIK-ut dhe

EULEX-it me rastin e dorëzimit të përgjegjësive, apo raportin e këtyre organeve me Policinë e Kosovës, apo “respektin e tyre për dhimbjen e ankuesit dhe familjarëve të tij”.

43. Përveç kësaj, përmes letrës së datës 11 nëntor 2019, ankuesi bëri parashtime shtesë rreth meritave të këtij rasti.
44. Në atë letër, ankuesi tha se ai ishte takuar vazhdimisht me përfaqësuesit e Misionit në lidhje me këtë çështje ku ata i kishin dhënë siguri se rasti i zhdukjes së vëllait të tij do të hetohej:

“Unë kam pasur disa kontakte me Misionin EULEX dhe përfaqësuesit e tij në zyrat e tyre në Mitrovicë dhe Graçanicë. Pothuajse gjithmonë më kanë siguruar me fjalë se rasti i zhdukjes me forcë të vëllait tim ishte regjistruar dhe se ai do të hetohej, dhe se unë do të njoftohesha me kohë rreth rezultateve të hetimeve të ndërmarra”.

Ankuesi theksoi më tej se pavarësisht kërkesave të tija të njëpasnjëshme për informim rreth gjendjes së progresit të hetimeve, ai asnjëherë nuk ka marrë përgjigje nga EULEX-i. Andaj ai kundërshton fuqishëm sugjerimin e Misionit se ai nuk ka kërkuar që ta informojë Misionin për këtë çështje.

45. Ankuesi po ashtu theksoi se, sipas mendimit të tij, Misioni ka dështuar që të veprojë me urgjencën dhe efektivitetin e nevojshëm për këtë çështje.
46. Si përgjigje ndaj pyetjes së Panelit nëse ai ka qenë në cijenë rreth ndonjë përpjekje nga ana e autoriteteve të vendit për hetimin e këtij rasti, ankuesi tha se ai nuk kishte njohuri të tilla dhe theksoi se ata asnjëherë nuk e kishin kontaktuar atë. Ai e shpjegoi gjendjen si

“fakt shkatërrues si nga ana njerëzore ashtu edhe nga ana e parimeve të proklamuar të Konventës për të drejtat e njeriut dhe të drejtat që burojnë nga ajo.”

47. I pyetur nëse Misioni ia kishte shkelur të drejtat e tij themelore, ankuesi kishte thënë se po dhe kishte theksuar si në vijim:
- *Obligimi* i Misionit për hetimin e këtyre rasteve del prej dispozitave të neneve 2-3 të Konventës Evropiane, e cila e mandaton Misionin që të garantojë efektivitetin e këtyre të drejtave në kontekstin e funksionit të tij ekzekutiv;
 - Neni 2 i Konventës Evropiane përveç obligimit pozitiv po ashtu parasheh obligimin procedural i cili përbëhet prej zbatimit të hetimit efektiv i cili ekziston edhe në rastet e zhdukjeve me forcë;
 - Neni 3 i Konventës Evropiane nënkupton se çdo hetim, përfshirë atë nga neni 2, duhet të ketë mundësinë e çuarjes në identifikimin dhe ndëshkimin e përgjegjësve.

- Neni 8 i Konventës Evropiane është pohuar të jetë shkelur meqë ankuesit i është mohuar e drejta për ta ditur të vërtetën rreth fatit të vëllait të tij.
 - Neni 13 i Konventës Evropiane garanton të drejtën për mjete efektive para të drejtës nacionale për secilin të drejtat dhe liritë e të cilit janë shkelur, të cilat ankuesi thotë se janë shkelur në këtë rast meqë Misioni nuk i ka ndjekur rrugët e kërkimeve relevante për gjetjen e rrethanave të zhdukjes së vëllait të ankuesit.
48. Lidhur me pasojat – personale, financiare, juridike dhe emocionale – të ndërlidhura me zhdukjen e familjarit të tij, ankuesi tha si në vijim:

“Për mua dhe familjen time, zhdukja me forcë e vëllait tim është shënuar me dhimbje të mëdha mendore dhe trauma që kanë qenë vazhdimisht të pranishme 19 vite. Ne nuk e dimë nëse ai është i gjallë apo i vrarë, nëse u vra, nëse u trajtua në mënyrë çnjerëzore, duke pasur parasysh se ai ishte rrëmbyer (kidnapuar) nga anëtarët e forcave të armatosura shqiptare, kush e vrau dhe ku gjenden eshtrat e tij. Ndjenja emocionale e një personi që mbetet pa një anëtar të familjes kuptohet vetëm nga ata që kanë kaluar nëpër një përvojë të tillë në një konflikt ndëretnik, prandaj dhembja jonë dhe agonia e kërkimit të tij në një institucion në tjetrin (ndërkombëtar dhe të vendit) nuk mund të përshkruhet me fjalë. Duke respektuar pyetjen tuaj në lidhje me pasojat financiare, besoj se kjo është një çështje dytësore në këtë moment, duke pasur parasysh që vëllai im [...] në regjistra është akoma i regjistruar si i gjallë, dhe se të gjitha përpjekjet e mia dhe të familjes sime janë drejtuar drejt gjetjes së tij ose të eshtrave të tij, dhe ndjekjen penale të personave përgjegjës, në mënyrë që të qetësojmë mendjen tonë, pavarësisht pasojave financiare të zhdukjes së tij.

IV. SHQYRTIMET

“Zhdukja me forcë” si shkelje e rëndë e të drejtave themelore të viktimave

49. Praktika e zhdukjes me forcë është një nga shkeljet më flagrante të të drejtave të njeriut. Aty nuk përfshihet shkelja e vetëm një të drejte, por e shumë të drejtave, duke përfshirë në shumë raste, të drejtën për të vërtetën, të drejtën për t'u njohur si person para ligjit, të drejtën për liri dhe sigurinë e personit dhe të drejtën për të mos iu nënshtruar torturës dhe trajtimit ose dënimit tjetër mizor, çnjerëzor ose poshtërues, të drejtën për një zgjidhje efektive dhe një veprim i tillë cenon ose përbën kërcënim të rëndë për të drejtën për jetë. *Shih, p.sh., Sadiku-Syla kundër EULEX-it*, 2014-34, Vendimi dhe Gjetjet, 19 tetor 2016, par. 33; *S.H. kundër EULEX*, Vendimi dhe gjetjet, rasti nr. 2016-28, 11 Shtator 2019, para. 61; *Deklarata për mbrojtjen e të gjithë personave nga zhdukja me forcë*, A/RES/47/133, 18 dhjetor 1992.
50. Çka është në veçanti e rëndësishme në atë kontekst është e drejta e ankuesit për të vërtetën, d.m.th. e drejta e viktimave për të ditur se çfarë ka ndodhur me të afërmit e tyre dhe rrethanat në të cilat ata janë zhdukur. *Shih, në përgjithësi, S.H. kundër EULEX*, Vendimi dhe gjetjet, rasti nr. 2016-28, 11 shtator 2019, para. 62; *Desanka dhe Zoran Stanisić kundër EULEX*, 2012-22, 11 nëntor 2015, para. 67; *Shih edhe El-Masri v Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë*, Aplikacioni nr. 39630/09, Aktgjykimi i GjEDNj i datës 12 dhjetor 2012, para. 191-193; *Orhan v. Turqia*, Aplikacioni nr. 25656/94, Aktgjykimi i GjEDNj i datës 18 qershor 2002, para. 358; *Imakayeva v. Rusia*, Aplikacioni

nr. 7615/02, Aktgjykimi i GjEDNj i datës 9 nëntor 2006, para 164; *Velásquez Rodríguez v. Honduras*, aktgjykimi i datës 29 korrik 1988, para. 181; *Heliodoro Portugal v. Panama*, aktgjykimi i datës 12 gusht 2008, para. 244; *Anzualdo Castro v. Peru*, aktgjykimi i datës 22 shtator 2009, para. 116-118; *Komenti i përgjithshëm për të drejtën për të vërtetën në lidhje me zhdukjet me forcë*, Raporti i Grupit Punues për zhdukjet me forcë apo në mënyrë të pavullnetshme, 2010, në veçanti, para. 1, Dokumenti A/HRC/16/48; *Lista e parimeve për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut përmes veprimeve për të luftuar mosndëshkueshmërinë (E/CN.4/2005/102/Add.1)*, në veçanti, parimet 2-4; dhe, gjithashtu, *Konventa ndërkombëtare për mbrojtjen e të gjithë personave nga zhdukja me forcë, e miratuar më 20 dhjetor 2006, në veçanti, Preambula dhe neni 24 (2); dhe, për një ilustrim, rasti i Gudiel Alvarez et al. ("Diario Militar") kundër Guatemalës, Aktgjykimi i 20.11.2012; Meritat, reparacionet dhe shpenzimet, par. 301 (dhe referencat e cituara).*

51. Për pothuajse dy dekada, ankuesi ka jetuar me pasiguri rreth fatit të vëllait të tij, se çka i kishte ndodhur dhe në çfarë rrethanash ai ishte zhdukur. Vuajtjet psikologjike nga kjo janë tejet të rënda. Ato janë vazhdimisht të pranishme. Misioni nuk ka bërë asgjë apo ka bërë shumë pak për të larguar ndjenjën se Misioni do ta përmbushte obligimin e tij në lidhje me familjarin e tij; përkundrazi, ai i ka dhënë ankuesit siguri se ai do ta hetonte këtë rast. Shih edhe *S.H. kundër EULEX*, Vendimi dhe gjetjet, rasti nr. 2016-28, 11 shtator 2019, para. 63; *D.W., E.V., F.U., G.T., Zlata Veselinović, H.S., I.R. kundër EULEX*, 2014-11 deri 2014-17, Vendimi mbi pranueshmërinë, 30 shtator 2015, para. 78; *Sadiku-Syla kundër EULEX*, 2014-34, Vendimi mbi pranueshmërinë, 29 shtator 2015, para. 35 dhe 42. Shih edhe, në kontekstin e nenit 3, GjEDNj, *Kurt v. Turqia*, aktgjykimi i datës 25 maj 1998, Raportet e aktgjykimeve dhe të vendimeve 1998- III, para.130-34; *Khadzhialiyev dhe të tjerët v. Rusia*, Aplikacioni nr. 3013/04, aktgjykimi i datës 6 nëntor 2008, para. 120-121; *Timurtas v Turqia*, Aplikacioni nr. 23531/94, Aktgjykimi i datës 13 qershor 2000, para. 95; Rezoluta nr. 828 e vitit 1984, paragrafi 3 (Asambleja parlamentare e Këshillit të Evropës); dhe *Komenti i përgjithshëm për nenin 17 të Deklaratës*, Raporti i grupit punues për zhdukjet me forcë apo në mënyrë të pavullnetshme 2000. Dokumenti E/CN.4/2001/68 (referimi dhe komentimi për nenin 17(1) të Deklaratës për mbrojtjen e të gjithë personave nga zhdukjet me forcë).
52. Natyra e vazhdueshme e shkeljes së të drejtave të përfshira në këtë praktikë e shpjegon se detyra e autoriteteve kompetente për hetimin e këtyre rasteve është obligim urgjent dhe i rëndësishëm i cili mund të lihet mënjanë apo të shtyhet për më vonë vetëm në rrethanat më të kufizuara. Shih *S.H. kundër EULEX*, Vendimi dhe gjetjet, rasti nr. 2016-28, 11 shtator 2019, para. 64.
53. E drejta për të vërtetën në lidhje me shkeljet e të drejtave të njeriut nuk është vetëm e drejtë individuale. Ajo gjithashtu është e drejtë kolektive, që shërben për ruajtjen e kujtimit në nivel të shoqërisë dhe vepron si mbrojtje kundër përsëritjes së shkeljeve. Shih *Komentin e përgjithshëm për të drejtën për të vërtetën në lidhje me zhdukjet me forcë, Raporti i Grupit Punues për zhdukjet me forcë apo në mënyrë të pavullnetshme, 2010, në veçanti, para. 1*, Dokumenti A/HRC/16/48; Preambula. Në kontekstin e paskonfliktit në Kosovë, hetimet e zhdukjeve me forcë është dashur që të kontribuonin – dhe duhet të vazhdojnë të kontribuojnë – për promovimin e të vërtetës, për kujtesën kolektive të shkeljeve të tilla të të drejtave të njeriut, dhe për të siguruar mospërsëritjen e tyre.
54. Kur është fjala për hetimin e rasteve të zhdukjeve me forcë, hetimet duhet të fillohen sa më parë që është e mundur dhe vonesat duhet të shmangen sa më shumë që është e mundur. Kjo jo vetëm për shkak të efektit të pasigurisë tek familjarët e mbijetuar, por edhe për shkak se provat do të zhduken apo të humben dhe kujtesa do të zbehet. Vonesat e hetimeve kështu do të kenë ndikim negativ tek mundësia që hetimet të gjejnë rrethanat në të cilat personi është zhdukur dhe që fajtorët të sillen para drejtësisë. Për

ilustrime të aplikimit të kësaj garancie në kontekste të ndryshme, shih në përgjithësi: *S.H. kundër EULEX*, Vendimi dhe gjetjet, rasti nr. 2016-28, 11 shtator 2019, para. 65; *Gürtekin dhe të tjerët v. Qipro*, Vendimi i GjEDNj për mospranueshmërinë i datës 11 mars 2014; *Al-Skeini dhe të tjerët v. Mbretëria e Bashkuar [GC]*, Aplikacioni nr. 55721/07, Aktgjykimi i GjEDNj i datës 7 korrik 2011; *Jalcud v. Holanda [GC]*, Aplikacioni nr. 47708/08, Aktgjykimi i GjEDNj i datës 20 nëntor 2011; *Jelić v. Kroacia*, Aplikacioni nr. 57856/11, Aktgjykimi i GjEDNj i datës 12 qershor 2014; *B. dhe të tjerët v. Kroacia*, Aplikacioni nr. 71593/11, Aktgjykimi i GjEDNj i datës 18 qershor 2015; *Palić v. Bosnja dhe Hercegovina*, Aplikacioni nr. 4704/04, Aktgjykimi i GjEDNj i datës 15 shkurt 2011; *Lejla Fazlić dhe të tjerët v. Bosnja dhe Hercegovina dhe 4 të tjerët*, Aplikacionet nr. 66758/09, 66762/09, 7965/10, 9149/10 dhe 12451/10, Aktgjykimi i GjEDNj i datës 3 qershor 2014; *Mujkanović dhe të tjerët v. Bosnja dhe Hercegovina*, Aplikacionet nr. 47063/08 et al., Vendimi i GjEDNj për mospranueshmërinë i datës 3 qershor 2014; *Nježić dhe Štimac v. Kroatia*, Aplikacioni nr. 29823/13, Aktgjykimi i GjEDNj i datës 9 prill 2015.

Detyrat dhe obligimet e autoriteteve në lidhje me aktet e zhdukjeve me forcë

55. Veprimet e prokurorëve dhe policisë së EULEX-it përbëjnë pjesë të mandatit ekzekutiv të EULEX Kosova në sektorët e drejtësisë, policisë dhe doganës. Si të tillë, ata hyjnë në fushëveprimin e mandatit të Panelit (shih, për shembull, *K deri T kundër EULEX*, 2013-05 deri 2013-14, 21 prill 2015, para. 43; *Krlić kundër EULEX*, 2012-21, 26 gusht 2014, para. 23; *Y kundër EULEX*, 2011-28, 15 nëntor 2012, para. 35). Kjo është çështja nëse veprimet themelore në fjalë përbejnë veprim pozitiv apo dështim i fajshëm. Shih *Krlić kundër EULEX*, 26 gusht 2014, par. 25; *S.H. kundër EULEX*, Vendimi dhe gjetjet, rasti nr. 2016-28, 11 shtator 2019, par. 48.
56. Paneli tashmë ka pasur rastin të potencojë se Misioni EULEX nuk është shtet dhe se mundësia e tij për të garantuar mbrojtjen efektive të të drejtave të njeriut nuk mund të krahasohet në të gjitha aspektet përkatëse me atë që mund të pritët prej një shteti (shih vendimin e Panelit në *A, B, C, D kundër EULEX-it*, 2012-09 në 2012-12, 20 qershor 2013, paragrafi 50, *K deri T kundër EULEX-it*, cituar më lartë, paragrafi 53, shih edhe vendimin e Panelit Këshillëdhënës të UNMIK për të Drejtat e Njeriut (PKDNj) në rastet nr. 248/09, 250/09 dhe 251/09, 25 prill 2013, paragrafi 35; *S.H. kundër EULEX*, Vendimi dhe gjetjet, rasti nr. 2016-28, 11 Shtator 2019, para. 49).
57. Pritshmëritë e vëna mbi mundësinë e EULEX-it për hetimin dhe zgjidhjen e rasteve penale të ndërlukuara duhet të jenë realiste dhe të mos i vënë EULEX-it obligime joproporcionale të cilat mandati dhe burimet e tij në mënyrë të arsyeshme nuk mund të priten të përmbushin (*L.O. kundër EULEX*, 2014-32, Vendimi dhe gjetjet, 11 nëntor 2015, para. 43 dhe 45, dhe referimet e tij te: vendimi i Panelit për *A,B,C,D kundër EULEX*, 2012-09 deri 2012-12, 20 qershor 2013, para 50; *K deri T kundër EULEX*, 2013-05 deri 2013-14, 21 prill 2015, para. 53; *Sadiku-Syla kundër EULEX*, 2014-34, Vendimi mbi pranueshmërinë, 29 shtator 2015, para. 35-37; *D.W., E.V., F.U., G.T., Zlata Veselinović, H.S., I.R. kundër EULEX*, 2014-11 to 2014-17, Vendimi mbi pranueshmërinë, 30 shtator 2015, para. 72-74; shih edhe vendimin e PKDNj për rastet nr. 248/09, 250/09 dhe 251/09, 25 prill 2013, para. 35 dhe para. 70-71).
58. Andaj, është e paraparë që Paneli të shqyrtojë nëse ka pasur pengesa konkrete dhe të vërteta të cilat mund të kenë rrezikuar kapacitetin e EULEX-it për të kryer hetime të menjëhershme dhe efektive për ndonjë rast. Ky vlerësim nuk ka për qëllim të arsyetojë mangësitë operationale që nuk janë të lidhura me sfida konkrete dhe të demonstrueshme. *L.O. kundër EULEX*, 2014-32, Vendimi dhe gjetjet, 11 nëntor 2015, para. 44; *S.H. kundër EULEX*, Vendimi dhe gjetjet, lënca nr. 2016-28, 11 shtator 2019, par. 50.

59. Në çdo rast, në veçanti në rastet e kësaj peshe, autoritetet hetimore janë të parapara që të veprojnë me kujdes dhe shpejtësi të arsyeshme dhe që të investojnë burime në proporcion me nevojën dhe mundësinë për zgjidhjen e rastit. Ndonëse nuk mund të pritët që autoriteti hetimor t'i zgjidhë të gjitha rastet që paraqiten para tij, nga ai pritët që të veprojnë me një kujdes, shpejtësi dhe efektshmëri që do të reflektonte peshën e çështjes që është nën hetim (*L.O. kundër EULEX*, 2014-32, Vendimi dhe gjetjet, 11 nëntor 2015, para. 46 dhe 59; shih edhe *Varnava dhe të tjerët v. Turqia*, Aplikacioni nr. 16064/90 e tutje, aktgjykimi i datës 18 shtator 2009, para. 191; *Palić v. Bosnja dhe Hercegovina*, Aplikacioni nr. 4704/04, aktgjykimi i datës 15 shkurt 2011, par. 63; *S.H. kundër EULEX*, Vendimi dhe gjetjet, lënda nr. 2016-28, 11 shtator 2019, par. 54).
60. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka përcaktuar një sërë parimesh të përgjithshme të cilat janë udhëzime se çka kërkon dhe pret e drejta për të drejtat e njeriut nga hetimet efektive për pretendimet e shkeljes së të crejtave nga neni 2 i Konventës Evropiane (*Mustafa Tunç dhe Fecire Tunç v. Turqia*, Aplikacioni nr. 24014/05, Aktgjykimi, 14 prill 2015 (salla e madhe), para. 169ff):

"169. ... Hetimet duhet të jenë, *inter alia*, të plota, të paanshme dhe të kryera me kujdes (shih *McCann dhe të tjerët v. Mbretëria e Bashkuar*, 27 shtator 1995, §§ 161-163, seria A nr. 324).

170. Forma e hetimit që ky obligim e kërkon dallon varësisht prej natyrës së cenimit së jetës: ndonëse hetimi penal është në përgjithësi i nevojshëm kur vdekja shkaktohet me qëllim, procedurat civile apo edhe disiplinore mund të plotësojnë këtë kriter kur vdekja ndodh si rezultat i neglizhencës (shih, *inter alia*, *Calvelli dhe Ciglio v. Italia*, cituar më lartë, § 51; *Mastromatteo v. Italia* [GC], nr. [37703/97](#), § 90, KEDNJ 2002-VIII; dhe *Vo v. Franca*, cituar më lartë, § 90).

171. Duke i kërkuar shtetit që të ndërmerr hapa të duhur për ruajtjen e jetës së atyre nën juridiksionin e tij, neni 2 shqipton detyrim mbi atë shtet që të sigurojë të drejtën për jetë përmes caktimit të dispozitave të të drejtës penale për pengimin e kryerjes së veprave kundër personit, të mbështetura me makinerinë e zbatimit të ligjit për parandalimin, ndalimin dhe ndëshkimin e shkeljeve të atyre dispozitave. Ky obligim kërkon me nënkuptim se duhet të ekzistojë njëfarë forme e hetimeve zyrtare efektive kur ka arsye për të besuar se ndonjë individ ka pësuar lëndime që ia kërcënojnë jetën në rrethana të dyshimta, edhe në rastet kur i dyshuari për kryerjen e sulmit fatal nuk është agent i shtetit (shih *Menson v. Mbretëria e Bashkuar* (vendimi), nr. [47916/99](#), KEDNJ 2003-V; *Pereira Henriques v. Luksemburg*, nr. [60255/00](#), § 56, 9 maj 2006; dhe *Yotova v. Bullgaria*, nr. [43606/04](#), § 68, 23 tetor 2012).

172. Në mënyrë që hetimi të jetë 'efektiv' siç cuhet kuptuar kjo shprehje në kontekstin e nenit 2 të Konventës, hetimi duhet së pari të jetë adekuat (shih *Ramsahai dhe të tjerët v. Holanda* [GC], nr. [52391/99](#), § 324, KEDNJ 2007-II). Pra, ai duhet të jep mundësinë që të shpije në gjetjen e fakteve dhe, kur është e mundur, në identifikimin dhe dënimin e përgjegjësve.

173. Obligimi për zhvillimin e hetimit efektiv nuk është obligim i rezultatit por i mjeteve: autoritetet duhet t'i ndërmarrin masat e arsyeshme që i kanë në dispozicion për të gjetur provat që kanë të bëjnë me rastin në fjalë (shih *Jaloud v. Holanda* [GC], nr. [47708/08](#), § 186, KEDNJ 2014; dhe *Nachova dhe të tjerët v. Bullgaria* [GC], nr. [43577/98](#) dhe [43579/98](#), § 160, KEDNJ 2005-VII).

174. Autoritetet duhet të ndërmarrin çdo hap të arsyeshëm që ato munden për të gjetur prova në lidhje me rastin, përfshirë, *inter alia*, deklarata nga dëshmitarët okularë, prova forenzike dhe, kur është e mundur, autopsi që jep të dhëna të plota dhe të sakta të lëndimeve dhe një analizë objektive të konstatimeve klinike,

përfshirë shkaktarin e vdekjes. Çdo mangësi të hetimet që e rrezikon mundësinë e tyre për të gjetur shkaktarin e vdekjes apo personin përgjegjës do të rrezikojë që ky standard të mos përmbushet (shih *Giuliani dhe Gaggio v. Italia* [GC], nr. [23458/02](#), § 301, KEDNJ 2011).

175. Në veçanti, konkluzionet që dalin nga hetimi duhet të bazohen në analiza të plota, objektive dhe të paanshme të të gjithë elementëve relevantë. Mosndjekja e një vije të qartë të hulumtimeve rrezikon në masë vendimtare mundësinë e hetimit për të zbuluar rrethanat e rastit dhe, aty ku është e mundur, identifikimin e përgjegjësve (shih *Kolevi v. Bullgaria*, nr. [1108/02](#), § 201, 5 nëntor 2009).

176. Megjithatë, natyra dhe shkalla e inspektimit që e përmbushë pragun minimal të efektivitetit të hetimit varen nga rrethanat e rastit të caktuar. Është e pamundur që llojllojshmëria e situatave që mund të ndodhin të reduktohet me një listë kontrolluese të thjeshtë të veprimeve të hetimit apo me kritere të tjera të thjeshtësuara (shih *Tanrikulu v. Turqia* [GC], nr. [23763/94](#), §§ 101-110, KEDNJ 1999-IV; dhe *Velikova v. Bullgaria*, nr. [41488/98](#), § 80, KEDNJ 2000-VI).

177. Më tej, personat përgjegjës për hetimet duhet të jenë të pavarur nga kushdo që është i implikuar apo që ka gjasa të jetë i implikuar në incidentet. Kjo nënkupton mungesën e lidhjes hierarkike apo institucionale por edhe pavarësinë praktike (shih *Anguelova v. Bullgaria*, nr. [38361/97](#), § 138, KEDNJ 2002-IV).

178. Kriteri i shpejtësisë dhe i përshpejtimit të arsyeshëm është i nënkuptueshëm në këtë kontekst (shih *Al-Skeini dhe të tjerët*, cituar më lartë, § 167).

179. Përveç kësaj, hetimi duhet të jetë i qasshëm për familjarët e viktimës në masën e nevojshme për ruajtjen e interesave të tyre legjitime. Gjithashtu duhet të ekzistojë elementi i mjaftueshëm i inspektimit publik të hetimit, shkalla e së cilit mund të ndryshojë prej rastit në rast (shih *Hugh Jordan v. Mbretëria e Bashkuar*, nr. [24746/94](#), § 109, KEDNJ 2001-III). Qasja e kërkuar e qytetarëve apo e të afërmeve të viktimës, megjithatë, mund të parashihet në faza të tjera të procedurës (shih, në mesin e autoriteteve të tjera, *Giuliani dhe Gaggio*, cituar më lartë, § 304; dhe *McKerr v. Mbretëria e Bashkuar*, nr. [28883/95](#), § 129, KEDNJ 2001-III).

180. Neni 2 nuk shqipton detyrim mbi autoritetet hetimore që ato të përmbushin secilën kërkesë për ndonjë masë të caktuar hetimore të bërë nga ndonjë familjar përgjatë zhvillimit të hetimeve (shih *Ramsahai dhe të tjerët*, cituar më lartë, § 348; dhe *Velcea dhe Mazäre v. Rumania*, nr. [64301/01](#), § 113, 1 dhjetor 2009).

181. Pyetja se nëse ndonjë hetim ka qenë mjaftueshëm efektiv duhet të vlerësohet në bazë të të gjitha fakteve relevante dhe duke i pasur parasysh realitetet praktike të punës hetimore (shih *Dobriyeva dhe të tjerët v. Rusia*, nr. [18407/10](#), § 72, 19 dhjetor 2013; dhe *Qendra për burime juridike në emër të Valentin Câmpeanu v. Rumania* [GC], nr. [47848/08](#), § 147, 17 korrik 2014)."

61. Gjykata Evropiane ka theksuar një element tjetër të rëndësishëm të hetimeve në përputhshmëri me të drejtat e njeriut, përkatësisht, nevojën që autoritetet hetimore të kërkojnë ndihmën dhe bashkëpunimin e autoriteteve të tjera nëse dhe kurdo që këto të fundit mund të kenë në posedim informata dhe/apo burime relevante për përpjekjet e tyre për zhvillimin e hetimeve efektive. Shih, në përgjithësi, *rastin Güzelyurtlu dhe të tjerët v. Qipro dhe Turqia*, Aplikacioni nr. 36925/07, *Aktgjykimi*, 29 janar 2019, para. 229 dhe 232-233:

'229. Hulumtimi i sipërm i praktikës gjyqësore tregon se në shumicën e rasteve në të cilat Gjykata ka shqyrtuar mungesën e bashkëpunimit ose mos dërgimin e kërkesës për bashkëpunim mes shteteve në rastet ndërkombëtare, ajo e ka bërë atë gjatë vlerësimit të përputhshmërisë së përgjithshme nga ana e shtetit përkatës

me obligimin e tij procedural për hetime sipas nenit 2. Në këto raste mungesa e bashkëpunimit ka qenë vetëm një aspekt në mesin e të tjerëve gjatë shqyrtimit që gjykata ka bërë sa i përket efektivitetit të hetimeve të zhvilluara nga shteti përkatës, në përgjithësi, mos kërkitimi i bashkëpunimit nga një shtet tjetër (për shembull, Qipro në rastin *Rantsev*, cituar më lartë, § 241, dhe *Aliyeva dhe Aliyev*, cituar më lartë, § 78), përfshirë kur bashkëpunimi ka përfshirë mundësinë e transferimit të procedurave në një shtet tjetër (shih *Huseynova*, cituar më lartë, § 111). Gjykata ka trajtuar në mënyrë specifike mungesën e bashkëpunimit apo të ndihmës për ndonjë hetim të zhvilluar brenda juridiksionit të një shteti tjetër kontraktues në shumë pak raste, përkatësisht në rastin *O'Loughlin, Cummins dhe Rantsev* (shih paragrafët 223 dhe 225 më lartë).

[...]

232. Gjykata më parë ka shprehur qëndrim se gjatë interpretimit të Konventës duhet të kihet parasysh natyra e saj e veçantë si traktat për zbatimin kolektiv të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut (Shih *Ireland v. Mbretëria e Bashkuar*, 18 janar 1978, § 239, seria A nr. 25, duke iu referuar preambulës së saj; *Loizidou v. Turqia* (vërejtjet paraprake), cituar më lartë, § 70; dhe *Nada v. Zvicra* [GC], nr. [10593/08](#), § 196, KEDNJ 2012). Kjo natyrë kolektive mundet, në disa rrethana specifike, të nënkuptojë detyrë për shtetin kontraktues që të veprojë bashkërisht dhe të bashkëpunojë për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive që kanë marrë përsipër t'i sigurojnë në kuadër të juridiksionit të tyre (shih për shembull, në fushën e trafikimit ndërkufitar të njerëzve sipas nenit 4 të Konventës, *Rantsev*, cituar më lartë, § 289). Në rastet kur hetimi efektiv për ndonjë vrasje të paligjshme e cila ka ndodhur në juridiksionin e një shteti kontraktues kërkon përfshirjen e më shumë se një shteti kontraktues, Gjykata konstaton se natyra e veçantë e Konventës si traktat për zbatim kolektiv në parim përfshinë një obligim në anën e shteteve përkatëse për të bashkëpunuar në mënyrë efektive me njëri-tjetrin me qëllim të zbardhjes së rrethanave të vrasjes dhe sjelljen e kryerësve para drejtësisë.

233. Gjykata shprehë pikëpamjen se neni 2 mund të kërkojë nga të dy shtetet një obligim të dyanshëm për të bashkëpunuar me njëri-tjetrin, njëkohësisht duke nënkuptuar obligim për të kërkuar ndihmë dhe obligim për të dhënë ndihmë. Natyra dhe fushëveprimi i këtyre obligimeve në mënyrë të pashmangshme do të varen nga rrethanat e çdo rasti të caktuar, për shembull nëse pikët kryesore të provave gjenden në territorin e shtetit kontraktues përkatës apo nëse të dyshuarit kanë ikur atje.'

62. Zotimi dhe lidhja e pakompromis me ato standarde është veçanërisht e rëndësishme për një mision të sundimit të ligjit që vepron në kontekst pas konfliktit, siç është EULEX Kosova, i cili ka për qëllim të shërbejë si shembull i zotimit të shoqërisë për përfundimin e mosndëshkueshmërisë dhe për ngritje të ndjenjës së llogaridhënies tek ajo për shkeljet e rënda të të drejtave. Shih *S.H. kundër EULEX*, Vendimi dhe gjetjet, rasti nr. 2016-28, 11 shtator 2019, para. 55. Çfarëdo standardi që nuk e përfshinë standardin e cekur më lartë do të rrezikonte krijimin e një ndjerje të pranimit në heshtje të mosndëshkueshmërisë dhe mospërfilljes së kërkesës së viktimave për drejtësi dhe llogaridhënie (*S.H. kundër EULEX*, Vendimi dhe gjetjet, rasti nr. 2016-28, 11 shtator 2019, para. 55; *L.O. kundër EULEX*, 2014-32, Vendimi dhe gjetjet, 11 nëntor 2015, para. 46; *Sadiku-Syla kundër EULEX*, 2014-34, Vendimi dhe gjetjet, 19 tetor 2016, para. 37; Shih edhe *Varnava dhe të tjerët v. Turqia*, Aplikacioni nr. 16064/90 e tutje, aktgjykimi i datës 18 shtator 2009, para. 191; *Palić v. Bosnja dhe Hercegovina*, Aplikacioni nr. 4704/04, aktgjykimi i datës 15 shkurt 2011, par. 63; vendimi i PKDNj për lëndën nr. 248/09, 250/09 dhe 251/09, 25 prill 2013, par. 80).
63. Po ashtu duhet të theksohet për qëllimet aktuale se të crejtat që janë temë e ankesës aktuale janë në mesin e të drejtave më të rëndësishme të të drejtave themelore. Ato prekin interesat thelbësore të viktimave të supozuara dhe duhet të garantohen në të

gjitha rrethanat. Praktika e zhdukjeve me forcë përbënë shkelje flagrante të këtyre të drejtave. Kjo, *ndër të tjera*, reflektohet në faktin se praktika e “zhdukjeve me forcë” tani konsiderohet dhe karakterizohet si krim kundër njerëzimit, në veçanti, në Statutin e Gjykatës Penale Ndërkombëtare (Statuti i Romës, neni 7(1)(i)) dhe Ligjin për Dhomat e Specializuara dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar (L gji nr. 05/L-053) (neni 13(1)(i)). Shih edhe *S.H. kundër EULEX*, Vendimi dhe gjetjet, lënca nr. 2016-28, 11 shtator 2019, para. 59.

64. Implikimet e ndryshimeve të mandatit të Misionit pas mbylljes në qershor 2018 dhe implikimet e tij për qëllime të këtij rasti janë të trajtuara shkurtimisht në vazhdim.

Rastet e “zhdukjeve me forcë” në kontekstin e mandatit të Misionit

65. ShM-ja nuk e konteston se Misioni ka qenë kompetent për hetimin e këtij rasti dhe ka mundur ta bënte atë gjatë ushtrimit të kompetencave të tij juridiksionale.
66. Paneli tanimë ka përcaktuar se ky lloj i rasteve bie në kuadër të mandatit ekzekutiv dhe kompetencave hetimore/prokuroriale të Misionit. Shih, p.sh., *D.W., E.V., F.U., G.T., Zlata Veselinović, H.S., I.R. kundër EULEX*, 2014-11 deri 2014-17, Vendimi mbi pranueshmërinë, 30 shtator 2015; *Sadiku-Syla kundër EULEX*, 2014-34, Vendimi mbi pranueshmërinë, 29 shtator 2015; *Zlata Veselinović, H.S., I.R. kundër EULEX*, 2014-11 deri 2014-17, Vendimi mbi pranueshmërinë, 30 shtator 2015; *L.O. kundër EULEX*, 2014-32, Vendimi dhe gjetjet, 11 nëntor 2015; *S.H. kundër EULEX*, Vendimi dhe gjetjet, rasti nr. 2016-28, 11 shtator 2019.
67. Kur aktet, si zhdukjet me forcë, kryhen në kontekstin e përgjithshëm të konfliktit të armatosur, siç ka ndodhur në këtë rast, veprimi në fjalë ka mundësi të cilësohet si krim lufte, krim kundër njerëzimit apo krim mbi baza etnike, për të cilat Misioni ka patur kompetencë juridiksionale specifike dhe direkte sipas mandatit në fuqi atë kohë. Shih, në përgjithësi, neni 3 (d) i veprimit të përbashkët të Këshillit. Shih edhe *Sadiku-Syla kundër EULEX*, 2014-34, 19 tetor 2016, para. 44-46. Në rastin *D.W. et al*, Paneli theksoi si në vijim në lidhje me këtë çështje:

‘ka ekzistuar mundësia e vërtetë që ato krime dhe shkeljet pasuese të të drejtave janë bazuar në përkatësi etnike apo fetare, duke u shtrirë kështu në territorin juridiksional për të cilin Misioni ka pasur kompetenca. Në një mjedis pas konfliktit ku raportet etnike dhe fetare ende mund të jenë të tensionuara dhe të brishta, këto raste qartazi janë prioritete hetimore.’

Shih *D.W., E.V., F.U., G.T., Zlata Veselinović, H.S., dhe I.R. kundër EULEX*, 2014-11 to 2014-17, 19 tetor 2016, para. 83 et seq, në veçanti par. 85.

68. Hetimi i këtyre llojeve të rasteve jo vetëm se ka qenë pjesë e mandatit të Misionit, por ka qenë edhe element thelbësor dhe esencial i tij. Në rastin *L.O. kundër EULEX*, Paneli theksoi se –

‘mund të ketë pak kontestim se hetimi i fatit të të zhdukurve – pavarësisht përkatësisë fetare apo etnike – duhet të jetë dhe duhet të mbetet prioritet operacional për EULEX-in si Mision i sundimit të ligjit, për çka ai duhet të pajiset me burime adekuate’

L.O. kundër EULEX, lënca nr. 2014-32, Vendimi dhe gjetjet, 11 nëntor 2015, para. 47. Shih edhe *S.H. kundër EULEX*, Vendimi dhe gjetjet, rasti nr. 2016-28, 11 shtator 2019.

69. Konsiderimet e sipërme do të shërbejnë për vlerësimin e përpjekjeve të bëra nga Misioni në lidhje me rastin aktual duke i pasur parasysh mandatin e përgjithshëm të Misionit dhe obligimet e tij për të drejtat e njeriut.

Rrethanat në të cilat Misioni është dashur t'i përmbushë përgjegjësitë e veta për të drejtat e njeriut

70. Për arsyet e dhëna më lartë, Misioni nuk duhet të vlerësohet kundrejt standardeve të përsosmërisë. Atë kohë Misioni është ballafaquar me një mjedis sfidues të pas konfliktit. Burimet e tij ishin të kufizuara dhe, në disa aspekte, ato ishin joadekuate për detyrën dhe pritshmëritë. Kjo ka bërë që Misioni të bëjë zgjedhje dhe të prioritzojë përpjekje të caktuara kundrejt të tjerave.
71. Më tej, mënyra në të cilën UNMIK-u i ka ndërmarrë përpjekjet e veta hetimore dhe mënyra në të cilën ai i ka transferuar dosjet e veta te EULEX-i kanë ndërlikuar në masë të madhe punën e Misionit. Si reagim, Misioni ka investuar kohë, burime dhe energji në shqyrtimin e atyre regjistrave dhe në përpjekjet për t'i qartësuar ato. Për këto përpjekje, Misioni duhet të përgëzohet.
72. Në vlerësimin e kësaj ankese, Paneli ka marrë parasysh vështirësitë e përfshira në hetimin e krimeve të pas luftës në një shoqëri pas konflikti siç është Kosova (*L.O. kundër EULEX*, 2014-32, 11 nëntor 2015, para. 44 dhe referencat e cituara aty; *S.H. kundër EULEX*, Vendimi dhe gjetjet, rasti nr. 2016-28, 11 shtator 2019, para. 51; Shih edhe *Palić v. Bosnja dhe Hercegovina*, Aplikacioni nr. 4704/04, aktgjykimi i datës 15 shkurt 2011, para. 70; dhe vendimi i PKDNj për rastet nr. 248/09, 250/09 dhe 251/09, cituar më lartë, para. 44 dhe 62 e *tutje*).
73. Ato vështirësi, megjithatë, nuk duhet të shërbejnë për të kamufluar apo arsyetuar dështimet hetimore të cilat nuk janë të lidhura në asnjë mënyrë kuptimplote me vështirësitë e cekura. Andaj, Paneli do të vlerësojë në çdo rast nëse ndonjë hap i caktuar hetimor që normalisht ka qenë i hapur për EULEX-it do të ishte bërë jopraktik për arsye që ndërlidhen me rrethanat e paskonfliktit pavarësisht atyre që kanë zhvilluar hetimin (*L.O. kundër EULEX*, 2014-32, Vendimi dhe gjetjet, 11 nëntor 2015, para. 44; *S.H. kundër EULEX*, Vendimi dhe gjetjet, rasti nr. 2016-28, 11 shtator 2019, para. 51).
74. Diçka që është në veçanti relevante për vlerësimin e reagimit të Misionit është fakti se mundësia e tij për përmbushjen e obligimeve të tij – hetimore – është ndikuar si nga rrethanat e përgjithshme në të cilat krimet janë kryer ashtu edhe nga veprimi i UNMIK-ut pas kryerjes së atyre krimeve. Krimet e kryera në kontekstin e konfliktit të armatosur janë pothuajse gjithnjë sfidë për t'u hetuar. Sfidë shpesh mbetet menjëherë pas konfliktit për shkak se provat mund të shkatërrohen dhe gatishmëria dhe mundësia e dëshmitarëve për dhënien e informatave mund të ulet rë masë të konsiderueshme në një kontekst të tillë. Paneli i ka marrë parasysh mirë këto sfida me rastin e vlerësimit që ia ka bërë reagimit të Misionit. Shih, prapë, *S.H. kundër EULEX*, Vendimi dhe gjetjet, lënda nr. 2016-28, 11 shtator 2019, par. 52-53.
75. Paneli po ashtu ka marrë parasysh faktin se EULEX Kosova është dashur që të ballafaqohej me trashëgiminë hetimore të UNMIK-ut dhe të trajtojë atë. Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut i Kombeve të Bashkuara ka konstatuar se UNMIK në shumë aspekte ka dështuar që t'i përmbushë obligimet e veta për të drejtat e njeriut sa i përket viktimave të "zhdukjeve me forcë" në disa raste. Mbajtja e duhur, me kujdes dhe e organizuar e informatave rreth kryerjes së shkeljeve të tilla të rënda të të drejtave është element i rëndësishëm i mbrojtjes efektive të atyre të drejtave. Paneli nuk do t'ia atribuon Misionit mangësitë dhe të metat të cilat duhet t'i drejtohen UNMIK-ut. Paneli ka marrë në konsiderim ato rrethana me rastin e vlerësimit të veprimeve të Misionit dhe të

sfidave me të cilat është ballafaquar. *S.H. kundër EULEX*, Vendimi dhe gjetjet, lënda nr. 2016-28, 11 shtator 2019, par. 53.

Gjetjet rreth dështimeve të pretenduara të Misionit

76. Siç është theksuar më lartë, është pak e kontestueshme se Misioni ka punuar në rrethana të vështira për shumicën e kohës sa i përket këtij rasti. Po ashtu është e dukshme se burimet e Misionit kanë qenë të kufizuara për nga natyra, dhe, në disa aspekte, joadekuate për pritshmëritë. Gjendja dhe natyra e çorganizuar e dosjeve që janë marrë nga UNMIK-u po ashtu e ka komplikuar në masë të madhe punën e Misionit.
77. Relevante është edhe shkalla e detyrës së pritur prej Misionit. Rastet e personave të zhdukur kanë qenë të shumta, të ndërlikuara dhe që kërkonin shumë burime. Në atë aspekt, është e arsyeshme që Misioni të sugjeron nevojën për bërjen e zgjedhjeve dhe që vendimet për priorizim kanë qenë të domosdoshme dhe të arsyeshme në ato rrethana.
78. Pavarësisht këtyre rrethanave, të cilat kanë prekur mundësinë e Misionit për kryerje të hetimeve të plota dhe efektive të të gjitha rasteve të zhdukjeve me forcë, Paneli prapë se prapë konstaton se Misioni nuk ka bërë mjaftë për të mbrojtur dhe garantuar të drejtat themelore të ankuesit. Paneli ka identifikuar një sërë mangësish tek veprimet e Misionit të cilat kanë rezultuar apo kanë kontribuar në shkeljen e të drejtave të ankuesit:
 - i. Hetimi jo i plotë dhe jo me kujdes i rastit; dhe
 - ii. Përfshirja dhe informimi i pamjaftueshëm i familjarëve të të zhdukurit.

Hetimi i zhdukjes së familjarit të ankuesit

79. Deri më 15 prill 2014, EULEX Kosova ka pasur kompetencë të papenguar për hetimin e rasteve të këtij lloji (Shih Ligji nr. 03/L-053 për Juridiksionin, Përzgjedhjen dhe Caktimin e Lëndëve Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë, neni 3, dhe Ligji nr. 03/L-052 për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës). Paneli ka theksuar në vendime të mëparshme se raste të këtij lloji kanë mundur të hetohet – dhe, në të vërtetë, në disa raste, janë – hetuar si krime të luftës apo krime të motivuara etnikisht. Andaj, nga fillimi i mandatit të tij deri në prill 2014 (pra, përfshirë periudhën e pas-lirimit nga akuza, 2007-2014), Misioni në të vërtetë ka qenë kompetent për hetimin apo vazhdimin e hetimit të këtij rasti. Shih *S.H. kundër EULEX*, Vendimi dhe gjetjet, rasti nr. 2016-28, 11 shtator 2019, para. 85.
80. Më 15 prill 2014, fushëveprimi i kompetencave të prokurorëve të EULEX-it është ngushtuar dhe kufizuar për “rastet në proces”, pra, për rastet që janë hapur nga EULEX-i para asaj kohe (Shih Ligjin nr. 04/L-273 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjeve për mandatin e EULEX-it, neni 3.3). Paneli thekson si në vazhdim në lidhje me periudhën mes prill 2014 dhe qershor 2018: Së pari, vendimi për hapjen apo moshapjen e një rasti të ri i përkiste prokurorëve të EULEX-it (në bashkëpunim me autoritetet kompetente të vendit) aty ku ekzistonin rrethana të jashtëzakonshme. Andaj, vendimi për të mos hapur apo për të mos rihapur ndonjë hetim të këtij rasti ishte vendim i marrë – në mënyrë shprehimore apo të nënkuptuar – nga prokurorët e EULEX-it. Shih edhe *X. dhe 115 të tjerët kundër EULEX*, Rasti nr. 2011-20, Vendimi dhe gjetjet, 22 prill 2015, par. 60-67; *S.H. kundër EULEX*, Vendimi dhe gjetjet, rasti nr. 2016-28, 11 shtator 2019, par. 86.
81. Ai obligim për hetim duhet të interpretohet nga aspekti i obligimeve të Misionit për të drejtat e njeriut sipas planit operacional. Duke pasur parasysh se shkelja e të drejtave

të viktimave dhe të ankuesit ka qenë e vazhdueshme, i ka takuar Misionit që të sigurojë se ato të drejta të mbrohen në mënyrë efektive dhe se shkelja e tyre të zgjidhet siç duhet.

82. Më tej, Ligji për Juridiksionin në fuqi gjatë asaj periudhe (prill 2014 - qershor 2018) ka përmbajtur një klauzolë në bazë të së cilës Misioni mund të zbatonte kompetencë në raste (pra, për ato që nuk kanë qenë “në proces” në maj) kur kanë ekzistuar “rrethana të jashtëzakonshme”. Paneli tani më ka patur rastin ta interpretojë këtë nocion. Ai e ka interpretuar atë në një mënyrë që i jep efekt përgjegjësisë së përgjithshme të Misionit për garantimin e mbrojtjes efektive të të drejtave të njeriut në kontekstin e mandatit të tij ekzekutiv. Andaj, në rastin *Sadiku-Syla*, Paneli theksoi s në vijim:

“ShM-ja parashtroi se legjislacioni i ri që ka hyrë në fuqi më 17 maj 2014 “ka zvogëluar në mënyrë të konsiderueshme mundësinë e prokurorëve dhe gjykatësve të EULEX-it që të ushtrojnë funksione ekzekutive në raste të reja” (Përgjigja, faqja 6, duke iu referuar Ligjit Omnibus që ka ndryshuar Ligjin për juridiksionin). Paneli vëren, megjithatë, se neni 7(A) përcakton “Autoritetin e prokurorëve të EULEX-it në rrethana të jashtëzakonshme”: “Në rrethana të jashtëzakonshme një lëndë do t’i caktohet një prokurori të EULEX-it me një vendim të përbashkët të kryeprokurorit të shtetit dhe autoritetit kompetent të EULEX Kosova.” ShM nuk ka shpjeguar se përse kjo dispozitë nuk do të ishte bazë ligjore adekuate mbi të cilën duhet të veprojnë prokurorët e EULEX-it, në veçanti në një rast si rasti në fjalë, ku autoritetet vendore nuk duket se janë duke kryer hetime. Paneli do t’i ftonte palët të adresojnë këtë çështje nëse ata dëshirojnë të bëjnë parashtresa shtesë në lidhje me meritat e këtij rasti”.

Shih *Sadiku-Syla kundër EULEX*, 2014-34, 29 shtator 2015, para. 62. Shih edhe, *D.W., E.V., F.U., G.T., Zlata Veselinović, H.S., I.R. kundër EULEX*, 2014-11 deri 2014-17, 30 shtator 2015, para. 90; *Sadiku-Syla kundër EULEX*, 2014-34, 19 tetor 2016, para. 23 et seq; *S.H. kundër EULEX*, Vendimi dhe gjetjet, rasti nr. 2016-28, 11 shtator 2019, para. 88.

83. Ndryshe, nga regjistri i rasteve që paraqiten para Panelit – përshirë rastin aktual – duket se EULEX-i në shumë raste nuk i ka trajtuar këto lloje të rasteve si prioritete hetimore apo, së paku, të përkushtojë kohë dhe burime të nevojshme për zhvillimin e hetimeve efektive për ato raste. Shih, p.sh., *Sadiku-Syla kundër EULEX*, 2014-34, Vendimi mbi pranueshmërinë, 29 shtator 2015, para. 34-39; *D.W., E.V., F.U., G.T., Zlata Veselinović, H.S., I.R. kundër EULEX*, 2014-11 to 2014-17, Vendimi mbi pranueshmërinë, 30 shtator 2015, para. 72-76; *L.O. kundër EULEX*, 2014-32, Vendimi dhe gjetjet, 11 nëntor 2015, para. 43-47, dhe 59-65; *Sadiku-Syla kundër EULEX*, 2014-34, Vendimi dhe gjetjet, 19 tetor 2016, para. 47; *D.W., E.V., F.U., G.T., Zlata Veselinović, H.S., I.R. kundër EULEX*, 2014-11 deri 2014-17, Vendimi dhe gjetjet, 19 tetor 2016, para. 58, 60, 62-65, 81-82; dhe *S.H. kundër EULEX*, Vendimi dhe gjetjet, rasti nr. 2016-28, 11 shtator 2019, para. 89.
84. Gjithashtu, ndërsa Misioni ka të drejtë të theksojë se përmasat e detyrës në fjalë dhe burimet e tij të kufizuara kërkonin vendime për caktimin e përparësive, Paneli nuk mund të pajtohet që kjo përbën shpjegim të vlefshëm për mosveprimin e Misionit në këtë rast. Së pari, nuk ka asnjë indikacion në regjistrin e këtij rasti se ndonjë kërkesë është bërë nga Misioni për të marrë burime shtesë për të mundësuar hetimin e këtij rasti (ose rasteve të këtij lloji).
85. Së dyti, në masën që prioritizimi bazohej në atë nëse dosjet ishin të klasifikuara si 'krime lufte' ose 'persona të zhdukur', një kriter i tillë nuk siguronte asnjë bazë të arsyeshme

për një vendim të tillë: një rast i krimit të luftës mund të përfshinë akte të zhdukjes me forcë ashtu si një rast i personave të zhdukur mund të përfshinë kryerjen e krimeve të luftës. Për më tepër, ky kualifikim nuk bazohej në "meritën" e rasteve individuale dhe në informatat në dispozicion. Ai nuk ishte i bazuar as në, siç do duhej të ishte, peshën e shkeljes së të drejtave të përfshira. Përkundrazi, ai u bazua në një lidhje teorike me konfliktin e armatosur, një kriter jo direkt i rëndësishëm për mbrojtjen efektive të të drejtave të njeriut. Aktet e zhdukjes me forcë përbëjnë shkelje të së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Por ato gjithashtu mund të përbëjnë shkelje të së drejtës ndërkombëtare humanitare (shiko Rregulloren 98, Studimin e të Drejtës Zakonore të ICRC) dhe krimet kundër njerëzimit (shih, p.sh., Statuti i ICC, neni 7 (1) (i)). Si i tillë, prioritetizimi i 'krimeve të luftës' mbi rastet e 'personave të zhdukur' nuk është vetëm normativisht i diskutueshëm, por gjithashtu nuk arrin të jap shpjegim të arsyeshëm për dështimin e Misionit për të hetuar rastet e zhdukjes me forcë, qofshin si raste të 'krimeve të luftës'.

86. Së treti, ky klasifikim i rasteve – 'dosje të krimeve të luftës' kundrejt 'dosje të personave të zhdukur' - ishte trashëgimi e veprimtarive të UNMIK-ut, të cilat Misioni kishte arsye të mira për të ditur se - siç duket nga parashtresat e saj - nuk ishte plotësisht i bazueshëm. Prandaj, ai duhet të kishte bërë vlerësimin e vet të dosjeve të rasteve dhe të bënte një vlerësim individual për secilën prej tyre, duke mos u bazuar në kategori gjenerike dhe jo plotësisht relevante të rasteve. Prandaj, Misioni duhet të kishte bërë vlerësim dhe hetim të individualizuar e jo t'i bazonte vendimet e tij për të hetuar në bazë të informatave që mund të kenë qenë tashmë në një dosje të UNMIK-ut.
87. Së fundmi, parashtresat e ankuesit sqarojnë se Misioni asnjëherë nuk u përpoq të shuaj shpresën dhe besimin e ankuesit se kjo çështje do të hetohej nga Misioni. Në vend të kësaj, ai mori siguri nga Misioni se ai do të hetonte (shih, supra, paragrafët 47 dhe 54).
88. Mungesa e dukshme e përqendrimit të qartë të prokurorisë në raste të këtij lloji, të cilat përfshijnë shkelje të rënda të së drejtës për jetë, dhe mungesa e një politike të qartë për trajtimin e rasteve të tilla si prioritet hetimor, mund të ketë ndikuar negativisht në aftësinë e Misionit për t'u përqëndruar në raste të këtij lloji.
89. Më tej, Paneli thekson se janë bërë pak apo edhe aspak përpjekje për rastet e këtij lloji dhe, në veçanti, për këtë rast, për të komunikuar me institucione dhe organizata të tjera (si KNKQ, ICTY/TNPJ; OJQ; autoritete të shtetit) të cilat kanë mundur të kenë informata rreth këtyre rasteve apo ekspertizë relevante për t'i ndihmuar përpjekjeve hetimore të Misionit. Në veçanti, Misioni ka pranuar se nuk ka kërkuar që të kontaktojë UNMIK-un në lidhje me këtë rast.
90. Para vendosjes për të mos hetuar një rast të kësaj pesëre, Misioni është dashur që t'i shtjerrë rrugët e arsyeshme të informimit, përfshirë përmes kontaktimit të familjarë ve të të zhdukurit dhe organizatat përkatëse për të siguruar nëse ata kanë informata rreth rastit.
91. Në bazë të kësaj që u tha më lartë, paneli gjen se Misioni nuk i ka përmbushur përgjegjësitë e veta hetimore drejt ankuesit dhe kështu ka kontribuar në shkeljen e të drejtave themelore të tij.

95. Në fund, Paneli thekson se mundësia e Misionit për hetimin e rasteve të këtij lloji është zvogëluar më tej me vendimin e shteteve të BE-së në vitin 2014 për *heqjen* e kapacitetit të inteligjencës dhe të hulumtimeve. Kur një mision i sundimit të ligjit themelohet me përgjegjësi për hetimin e rasteve penale të ndërlikuar, siç ka qenë ky rast, është përgjegjësi e shteteve dhe e organeve kompetente të BE-së për të siguruar që Misioni të pajiset me të gjitha burimet e nevojshme për përmbushjen e detyrave të veta në mënyrë efektive dhe në një mënyrë konsistente me obligimet për të drejtat e njeriut.

Informimi i familjarëve të të zhdukurve

96. Për shkak të ndikimit të akteve të zhdukjeve me forcë të familjarët e të zhdukurve, është thelbësishëm e rëndësishme që ata duhet të jenë të përfshirë në hetimin e rasteve të tilla në masën më të madhe që është e mundur. *S.H. kundër EULEX*, Vendimi dhe gjetjet, rasti nr. 2016-28, 11 shtator 2019, par. 66.
97. Autoriteteve hetimore iu kërkohet që, si çështje e së drejtës për të drejtat e njeriut, t'i informojnë viktimat e këtyre shkeljeve në lidhje me procesin e hetimeve të tyre. Në fakt, kjo kërkon që ato t'i balancojnë të drejtat dhe interesat e viktimave për të qenë të informuar rreth progresit të hetimeve me shkallën e nevojshme të konfidencialitetit që hetimet në mënyrë legjitime mund të kërkojnë. Duke iu nënshtuar konsiderimeve të konfidencialitetit dhe të sigurisë, viktimat kanë të drejtë që të jenë mjaftueshëm të përfshira në procesin e hetimeve dhe të jenë të informuara rreth tij. Ndonëse përmbajtja e saktë së asaj që duhet t'i jepet atyre është vështirë të përcaktohet në një përmbledhje, informatat e që iu jepen atyre që më së drejtpërdrejt janë të prekur nga hetimet duhet të jenë të atilla që ua bëjnë të mundur të jenë të përmbushur se çështja është duke u shqyrtuar siç duhet dhe se janë duke u bërë të gjitha përpjekjet relevante dhe të arsyeshme për gjetjen e fatit të familjarëve të tyre dhe për identifikimin e përgjegjësve të atyre akteve. Shih, në përgjithësi, *S.H. kundër EULEX*, Vendimi dhe gjetjet, rasti nr. 2016-28, 11 shtator 2019, para. 66; *Desanka dhe Zoran Stanisić kundër EULEX*, 2012-22, 11 nëntor 2015, para. 66; *L.O. kundër EULEX*, 2014-32, 11 nëntor 2015, para. 60-61, 72-73; PShDN, Shënim i praktikës gjyqësore për detyrën për hetimin e pretendimeve të shkeljeve të të drejtave, fq. 28-30; Shih edhe *Ahmet Özkan dhe të tjerët v. Turqia*, Aplikacioni nr. 21689/93, Aktgjykimi i GjEDNj i datës 6 prill 2004, para. 311-314, *Isayeva v. Rusia*, Aplikacioni nr. 57950/00, Aktgjykimi i GjEDNj i datës 24 shkurt 2005 para. 211-214; *Al-Skeini dhe të tjerët v. Mbretëria e Bashkuar*, Aplikacioni nr. 55721/07, Aktgjykimi i GjEDNj i datës 7 korrik 2011, par. 167.
98. Ky obligim për t'i informuar viktimat rreth përpjekjeve hetimore është në veçanti i rëndësishëm në rastet që përfshijnë akte të zhdukjes me forcë, meqë familjarët që kanë mbijetuar mund të mos kenë burime të tjera të informimit rreth fatit të të afërmeve të tyre dhe ata do të vazhdojnë të jetojnë me shpresën se fati i të afërmeve të tyre një ditë do të zbardhet. Si rezultat, familjarët e viktimave të zhdukura vuajnë emocionalisht nga mungesa e informatave rreth fatit të më të dashurve të tyre. Shih *Zufe Miladinović kundër EULEX*, 2017-02, 19 qershor 2019, para. 87; *S.H. kundër EULEX*, Vendimi dhe gjetjet, rasti nr. 2016-28, 11 shtator 2019, para. 78. Kjo kërkesë është element i nevojshëm i mbrojtjes së të drejtave të viktimave gjatë hetimit të rasteve të tilla. Shih, p.sh., *.H. kundër EULEX*, Vendimi dhe gjetjet, rasti nr. 2016-28, 11 shtator 2019, para. 77; *Desanka dhe Zoran Stanisić kundër EULEX*, 2012-22, 11 nëntor 2015, para. 66, duke iu referuar *L.O. kundër EULEX*, 2014-32, 11 nëntor 2015, para. 60-61, 72-74; *Zufe Miladinović kundër EULEX*, 2017-02, 19 qershor 2019, para. 86; Shih edhe *Ahmet Özkan dhe të tjerët v. Turqia*, Aplikacioni nr. 21689/93, Aktgjykimi i GjEDNj i datës 6 prill 2004, para. 311-314, *Isayeva v. Rusia*, Aplikacioni nr. 57950/00, Aktgjykimi i GjEDNj i datës 24 shkurt 2005 para. 211-214; *Al-Skeini dhe të tjerët v. Mbretëria e Bashkuar*,

Aplikacioni nr. 55721/07, Aktgjykimi i GjEDNj i datës 7 korrik 2011, para. 167. Dhe autoritetet kompetente nuk do të lejohen lehtë që të mos e përfillim apo ta injorojnë atë. Shih *S.H. kundër EULEX*, Vendimi dhe gjetjet, rasti nr. 2016-28, 11 shtator 2019, para. 67.

99. Në këtë kontekst është relevante edhe e drejta e viktimës për të vërtetën, e cila buron nga kategoritë e tjera të pranuara të të drejtave të njeriut. Duke e theksuar të drejtën e viktimave për të vërtetën në këtë kontekst, *Komenti i përgjithshëm* i grupit punues për zhdukjet me forcë thekson si në vijim në lidhje me këtë çështje:

“Neni 13 i Deklaratës njeh obligimin e shtetit për të hetuar rastet e zhdukjeve me forcë. Paragrafi 4 i nenit 13 specifikon se “gjetjet nga një hetim i tillë do të vihen në dispozicion sipas kërkesës për të gjithë personat e interesuar, përveç nëse veprimi i tillë do të rrezikonte hetimin penal që është në proces.” Duke pasur parasysh zhvillimet që kanë ndodhur që nga viti 1992, Grupi punues gjykon se kufizimi në pjesën e fundit të këtij paragrafi duhet të interpretohet ngushtë. Në të vërtetë, të afërmit e viktimave duhet të lidhen ngushtë me hetimin për rastin e zhdukjes me forcë. Refuzimi për të dhënë informacion është kufizim i së drejtës për të vërtetën. Një kufizim i tillë duhet të jetë rreptësishtë proporcional me qëllimin e vetëm të ligjshëm: për shmangien e rrezikimit të hetimit penal në proces. Refuzimi për të dhënë ndonjë informacion, ose për të mos komunikuar fare me të afërmit, me fjalë refuzimi absolut, është shkelje e së drejtës për të vërtetën. Dhënia e informatave të përgjithshme për çështjet procedurale, siç është fakti se çështja i është dhënë një gjykatësi për shqyrtim, është e pamjaftueshme dhe duhet të konsiderohet shkelje e së drejtës për të vërtetën. Shteti ka obligim që ta informojë çdo person të interesuar rreth hapave konkretë të ndërmarrë për zbardhjen e fatin të personit dhe vendndodhjen e tij. Këto informata duhet të përfshijnë hapat e ndërmarrë në bazë të provave të ofruara nga të afërmit ose dëshmitarët e tjerë. Ndërsa nevojat e hetimit penal mund të arsyetojnë kufizimin e transmetimit të informatave të caktuara, legjislacioni i vendit duhet të përcaktojë mundësinë për ta shqyrtuar një refuzim të tillë për t'i dhënë informata të gjithë personave të interesuar. Ky shqyrtim duhet të jetë në dispozicion në kohën e refuzimit fillestar për dhënie të informatave, dhe pastaj në mënyrë të rregullt për të siguruar që arsyetja e nevojës që është ngritur nga autoriteti publik për refuzimin e komunikimit, të vazhdojë të jetë e pranishme.”

Shih *Komentin e përgjithshëm për të drejtën për të vërtetën rreth zhdukjeve me forcë*, raporti i grupit punues për zhdukjet me forcë apo në mënyrë të pavullnetshme (2010), dokumenti A/HRC/16/48, para 3; *Zufe Miladinović kundër EULEX*, 2017-02, 19 qershor 2019, para. 87; dhe, po ashtu, I. *Rasti i Rio Negro Massacres/Masakrat e Lumit të Zi v. Guatemala* (GjNADNj) (Aktgjykimi i datës 4.09.2012, kundërshtimi preliminar, meritat, riparimi dhe kostot), para. 265. Shih edhe *S.H. kundër EULEX*, Vendimi dhe gjetjet, lënda nr. 2016-28, 11 shtator 2019, par. 78.

100. Sa i përket rastit aktual, Misioni ka pranuar se nuk janë bërë përpjekje për të komunikuar me ankuesin apo familjarët e të zhdukurit. Atyre familjarëve nuk i është përcjellë asnjë informatë që Misioni ka patur në posedim për këtë rast.
101. Misioni nuk ka dhënë shpjegime për mos informimin e ankuesit (apo të ndonjë familjari tjetër të viktimës parësore) rreth këtij rasti. Misioni, megjithatë, pranon pamjaftueshmërinë e përpjekjeve të tij komunikuese dhe faktin se ai ka mundur dhe është dashur të bënte më shumë për të informuar publikun për mandatin e tij dhe kufizimet (shih, *supra* 37).

102. Mos kontaktimi dhe mos informimi i ankuesit nga ana e Misionit sa i përket vendimit të tij për të mos e hetuar këtë rast dhe dështimi i tij për kontaktimin me ta dhe informimin e tyre për këtë rast ka kontribuar në shkeljen e të drejtave të ankuesit deri në atë masë sa që ka rritur gjendjen e pasigurisë në të cilën ai ka qenë gjatë periudhës përkatëse.

Mandati i ri i reduktuar i Misionit, që nga qershori 2018

103. Mandati i ri i Misionit, i cili ka hyrë në fuqi në qershor 2018, ka reduktuar në masë të konsiderueshme mundësinë e Misionit për hetimin e rasteve penale, përfshirë rastin aktual. Roli i tij i ri i monitorimit nuk ia mundëson që të kërkojë fillimin e ndonjë hetimi, e as nuk i jep autoritet për të vendosur rreth procesit të retimeve. *S.H. kundër EULEX*, Vendimi dhe gjetjet, rasti nr. 2016-28, 11 shtator 2019, par. 98.
104. Paneli konsideron se ndryshimi i natyrës së mandatit të Misionit nuk e liron Misionin nga obligimi i tij për zgjidhjen aq sa është e mundur të ndikimeve të shkeljeve për të cilat përcaktohet se është përgjegjës. Shih edhe *S.H. kundër EULEX*, Vendimi dhe gjetjet, rasti nr. 2016-28, 11 shtator 2019, par. 99; dhe Vendimi i Këshillit (CFSP) 2018/856 i datës 8 qershor 2018.
105. Mbi këtë bazë, Paneli do të rekomandojë që Misioni më tej të ndërmarrë hapa aktivë për të kërkuar nga autoritetet kompetente të vendit se çfarë masash, nëse ekziston ndonjë, janë duke u marrë për të hetuar këtë rast dhe për të raportuar tek autoritetet kompetente në Bruksel nëse bëhet e qartë se autoritetet e vendit nuk janë duke i përmbushur obligimet e tyre në atë aspekt. Për shkak të dështimit për mbrojtjen e të drejtave të ankuesit, Misioni tani duhet të ndërmarrë hapa për të kërkuar zgjidhjen e këtyre shkeljeve.

Pasoja mbi të drejtat e ankuesit

106. Neni 2 i Konventës mbron një prej të drejtave më themelore të njeriut, përkatësisht, të drejtën për jetë. Ajo e drejtë mbrohet me një varg instrumentesh për të drejtat e njeriut dhe ajo përbënë element thelbësor dhe bazik të mbrojtjes minimale të të drejtave të njeriut detyruar çdo individ. Ajo njih vetëm pak përjashtime, dhe të kufizuara. Shih, në përgjithësi, *Komenti i përgjithshëm nr. 36 (2018) për nenin 6 të Marrëveshjes ndërkombëtare për të drejtat civile dhe politike, për të drejtën për jetë*, CCPR/C/GC/36, 30 tetor 2018 (https://tbinternet.ohchr.org/Treaties/CCPR/Shared%20Documents/1_Global/CCPR_C_GC_36_8785_E.pdf) (më tej në tekst, "*Komenti i përgjithshëm 36*"); *S.H. kundër EULEX*, Vendimi dhe gjetjet, rasti nr. 2016-28, 11 shtator 2019, par. 106.
107. Më e rëndësishmja për qëllimet e tanishme, kjo e drejtë paraqet obligim procedural në anën e shtetit ose autoritetit kompetent për të hetuar aty ku ata e dinë ose duhet të kishin ditur për privimet potencialisht të paligjshme të jetës, për të hetuar dhe, kur është e përshtatshme, për të ndjekur penalisht raste të tilla, përfshirë pretendimet për përdorim të tepërt të forcës me pasoja vdekjeprurëse. Shih, në përgjithësi, *Sadiku-Syla kundër EULEX*, 2014-34, Vendimi dhe gjetjet, 19 tetor 2016; *D.W., E.V., F.U., G.T., Zlata Veselinović, H.S., I.R. kundër EULEX*, 2014-11 deri 2014-17, Vendimi mbi pranueshmërinë, 30 shtator 2015; *Sadiku-Syla kundër EULEX*, 2014-34, Vendimi mbi pranueshmërinë, 29 shtator 2015; *S.H. kundër EULEX*, Vendimi dhe gjetjet, rasti nr. 2016-28, 11 shtator 2019, para. 107; Shih edhe *Nydia Erika Bautista de Arellana v. Kolumbia*, komunikimi nr. 563/1993, Qëndrimet e komitetit për të drejtat e njeriut, 27 tetor 1995 para. 8.6; *McCann dhe të tjerët v. Mbretëria e Bashkuar*, Aktgjykimi i GjEDNJ i datës 27 shtator 1995, seria A nr. 324, para. 161; *Assenov dhe*

të tjerët v. Bullgaria, Aktgjykimi i GjEDNj i datës 28 tetor 1998, Raportet për gjykimet dhe vendimet 1998-VIII, par. 102; *Nachova dhe të tjerët v Bullgaria*, Aplikacioni nr.s. 43577/98 dhe 43579/98, Aktgjykimi i GjEDNj i datës 6 korrik 2005, para. 110; *Hugh Jordan v. Mbretëria e Bashkuar*, Aplikacioni nr. 24746/94, Aktgjykimi i GjEDNj 4 Maj 2001, para. 105; *Komenti i përgjithshëm* 36, par. 27; Këshilli për të drejtat e njeriut, vërejtjet përmbyllëse: Kirgistan (2014), par. 13.

108. Hetimet dhe ndjekjet penale të privimeve potencialisht të paligjshme nga jeta duhet të ndërmerren në pajtueshmëri me standardet ndërkombëtare relevante, përfshirë *Protokollin e Minesotës për hetimin e vdekjeve potencialisht të paligjshme* (2016), dhe duhet të kenë për qëllim të sigurojnë sjelljen e përgjegjësve para drejtësisë, promovimin e llogaridhënies dhe parandalimin e mosndëshkueshmërisë, mënjanimin e shmangies nga drejtësia dhe nxjerrjen e mësimave të nevojshme për revidimin e praktikave dhe politikave me qëllim të shmangies së përsëritjes së shkeljeve. Shih, në përgjithësi, *Komenti i përgjithshëm* 36, para. 27 dhe referencat e cituara; dhe *S.H. kundër EULEX*, Vendimi dhe gjetjet, rasti nr. 2016-28, 11 shtator 2019, par. 108.
109. Për këtë rast relevant është edhe neni 3 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, me të cilin përcaktohet se askush nuk i nënshtrohet torturës apo trajtimin apo ndëshkimit çnjerëzor apo degradues. Një ndalesë dhe garanci e ngjashme përcaktohet edhe në shumë instrumente të tjera për të drejtat e njeriut, përfshirë në nenin 7 të Marrëveshjes ndërkombëtare për të drejtat civile dhe politike dhe nenin 2 të Konventës kundër torturës dhe trajtimit apo ndëshkimit tjetër mizor, çnjerëzor apo degradues. Kjo prapë është e drejtë themelore e një rëndësie enorme e cila duhet të mbrohet në çdo kohë dhe rrethanë.
110. Në jurisprudencën e Panelit dhe në praktikën e organeve të tjera për të drejtat e njeriut është pranuar se trauma emocionale që shkaktohet tek familjarët e ndonjë të zhdukuri nga mungesa e informatave rreth fatit të të afërmit të tyre mund të arrijë pragun e peshës që kërkohet për këtë garanci. Shih, p.sh., *L.O. kundër EULEX*, 2014-32, Vendimi dhe gjetjet, 11 nëntor 2015; *D.W., E.V., F.U., G.T., Zlata Veselinović, H.S., I.R. kundër EULEX*, 2014-11 to 2014-17, Vendimi mbi pranueshmërinë, 30 shtator 2015; *Sadiku-Syla kundër EULEX*, 2014-34, Vendimi dhe gjetjet, 19 tetor 2016; *S.H. kundër EULEX*, Vendimi dhe gjetjet, rasti nr. 2016-28, 11 shtator 2019. Shih edhe *Deklaratën për mbrojtjen e të gjithë personave nga zhdukjet me forcë*, paragrafi preambular i 5-të (ku theksohet se zhdukjet me forcë shkaktojnë “ankth dhe pikëllim”) dhe neni 1(2) ku përcaktohet se “[ç]do akt i zhdukjes me forcë (...) përbënë shkelje të rregullave të së drejtës ndërkombëtare që garanton, (...) të drejtën për të mos iu nënshtrohet torturës apo trajtimit apo ndëshkimit tjetër mizor, çnjerëzor apo degradues”; dhe *Komentin e përgjithshëm për të drejtën për të vërtetën në lidhje me zhdukjet me forcë*, Raporti i grupit punues për zhdukjet me forcë apo në mënyrë të pavullnetshme, 2010. Dokumenti A/HRC/16/48, par. 4.
111. Në pikëpamjen e Panelit, dështimi i Misionit për a) informimin e të afërmeve rreth veprimeve të Misionit në lidhje me këtë rast dhe b) përdorimin e të gjitha mjeteve hetimore në dispozicion për t'u përpjekur për ta zgjidhur këtë rast, të gjitha kanë kontribuar në shkeljen e të drejtave të ankuesit nga neni 2 i Konventës për hetimin e këtij rasti në mënyrë të plotë dhe me kujdes nga ana e Misionit.
112. Këto dështime dhe lëshime fajësuese po ashtu kanë kontribuar në shkeljen e të drejtave të ankuesit nga neni 3 i Konventës dhe kanë kontribuar në traumën emocionale dhe psikologjike të shkaktuar nga mosdija se çka i ka ndodhur vëllait të tij. Ajo traumë është e rëndë, e gjatë dhe e vazhdueshme. Në lidhje me atë, Misioni citon edhe njëherë parashtresat e ankuesit në lidhje me ndikimin që zhdukja e vëllait të tij ka patur tek ai dhe tek familja e tij:

“Për mua dhe familjen time, zhdukja me forcë e vëllait tim është shënuar me dhimbje të mëdha mendore dhe trauma që kanë qenë vazhdimisht të pranishme 19 vite. Ne nuk e dimë nëse ai është i gjallë apo i vrarë, nëse u vra, nëse u trajtua në mënyrë çnjerëzore, duke pasur parasysh se ai ishte rrëmbyer (kidnapuar) nga anëtarët e forcave të armatosura shqiptare, kush e vrau dhe ku gjenden eshtrat e tij. Ndjenja emocionale e një personi që mbetet pa një anëtar të familjes kuptohet vetëm nga ata që kanë kaluar nëpër një përvojë të tillë në një konflikt ndëretnik, prandaj dhembja jonë dhe agonja e kërkimit të tij në një institucion në tjetrin (ndërkombëtar dhe të vendit) nuk mund të përshkruhet me fjalë.”

113. Shkelja e të drejtave themelore të ankuesit nuk është, natyrisht, pasojë ekskluzive e veprimit të Misionit, por Paneli nuk është kompetent që të bëjë përcaktime rreth përgjegjësisë së UNMIK-ut në atë drejtim. Sido që të jetë, dështimi i UNMIK-ut, sado i rëndëm nuk do ta arsyetonte atë të Misionit. Andaj, gjetjet e bëra këtu kufizohen në aktet dhe dështimet e Misionit që i kanë kontribuar shkeljes së të drejtave të ankuesit dhe atë vëllait të tij, duke i pasur parasysh sfidat e cekura më lartë me të cilat është përballur Misioni atë kohë.
114. Në aspektin e gjetjeve të paraqitura më lartë për nenet 2 dhe 3 të Konventës, Paneli nuk është i mendimit se ka nevojë që të konstatojë gjetje edhe për nenet 8 dhe 13 të Konventës. Paneli thekson, megjithatë, se ndonëse interesi (interesat) e mbrojtura nga çdo dispozitë kanë ngjashmëri të pjesërishtme, ato nuk janë identike. Paneli thekson, më tej, se veprimi që i atribuohet Misionit duket *prima facie* të ketë prekur negativisht të drejtat e ankuesit për jetë familjare dhe të drejtën e tij për zgjidhje efektive. Paneli nuk do të bëjë gjetje definitive për këto të drejta meqë gjetjet e tij për nenet 2 dhe 3 përmbledhin ato që ai i konsideron tipare thelbësore të shkeljeve që i atribuohen Misionit.
115. Në bazë të asaj që u tha më lartë, Paneli ka përcaktuar se Misioni i ka shkelur të drejtat e ankuesit nga neni 2 (pjesë procedurale) dhe neni 3 i Konventës.

PËR KËTO ARSYE, PANELI NJËZËRI

GJEN se Misioni i ka shkelur të drejtat e ankuesit të garantuara me nenin 2 (dega procedurale) dhe me nenin 3 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;

NË BAZË TË KËSAJ, PANELI NUK E KONSIDERON TË NEVOJSHME të bëjë përcaktime rreth shkeljeve të mundshme të neneve 8 dhe 13 të Konventës nga ana e Misionit;

THEKSON se, në bazë të të dhënave që Paneli i posedon, shkelja e të drejtës së ankuesit mund të jetë në vazhdim e sipër, andaj,

REKOMANDON si në vijim:

- i. Duke marrë parasysh peshën e shkeljeve nën shqyrtim, Paneli i bën ftesë Shefit të Misionit që me kujdes ta shqyrtojë mundësinë dhe nevojën që Misioni të pranon shkeljen e të drejtave të ankuesit nga ana e Misionit;
- ii. Paneli i bën ftesë Misionit që të sigurojë se dosja e këtij rasti dhe ky vendim t'i dërgohen autoriteteve kompetente të vendit;
- iii. Paneli rekomandon që ky rast duhet të jetë subjekt i monitorimit nga Misioni;

- iv. Paneli rekomandon se, siç ka bërë për rastin 2017-02, Misioni duhet të shqyrtojë dhënien e rekomandimeve tek autoritetet në lidhje me proceset hetimore të mundshme në të ardhmen të cilat do të mund të ndihmonin për zgjidhjen e këtij rasti; në atë kontekst, Paneli rekomandon që Misioni duhet të theksojë para autoriteteve rëndësinë e të drejtave të viktimave për të vërtetën, faktin se shkelja është në vazhdim e sipër, dhe të bëjë me dije se mirëpret informata rreth zhvillimet e përgjithshme të het meve;
- v. Paneli rekomandon se Misioni duket të raportojë tek autoritetet kompetente në Bruksel nëse bëhet e qartë se autoritetet e vendit nuk janë duke i përmbushur obligimet e veta në atë aspekt;
- vi. Misioni duhet të ndërmerr hapa aktivë për të kërkuar nga autoritetet se çfarë hapa, nëse ka, janë duke u ndërmarrë për hetimin e këtij rasti dhe për të raportuar tek autoritetet kompetente të Bashkimit Evropian në Bruksel nëse bëhet e qartë se autoritetet nuk janë duke i përmbushur obligimet e veta në atë aspekt;
- vii. Paneli rekomandon që ky vendim duhet t'i jepet organeve përkatëse të Misionit; dhe
- viii. Paneli po ashtu rekomandon që Shefi i Misionit duhet të sigurojë se aktivitetet monitoruese të Misionit duhet të zhvillohen në konsistencë me obligimet e Misionit për të drejtat e njeriut dhe se Misioni të sigurojë se kjo pjesë e mandatit të tij i kontribuon mbrojtjes efektive dhe avancimit të atyre të drejtave.

PËRVEÇ KËSAJ, duke i pasur parasysh parashtresat e Misionit të datës 6 dhjetor 2019 ku Misioni ka cekur se jo të gjitha rastet kanë mundur të hetohen dhe se është dashur të merreshin vendime për prioritizim, **PANELI KËRKON NGA MISIONI QË TË JEP INFORMATAT SI NË VIJIM:**

- i. Sa raste të zhdukjeve me forcë ka marrë Misioni nga UNMIK-u?
- ii. Sa prej tyre janë hetuar nga Misioni gjatë mandatit të tij?
- iii. Sa prej tyre kanë rezultuar me procedim penal?
- iv. Sa raste 'të krimeve të luftës' ja marrë Misioni nga UNMIK-u?
- v. Sa prej tyre janë hetuar nga Misioni gjatë mandatit të tij?
- vi. Sa prej tyre kanë rezultuar me procedim penal?
- vii. Cilët faktorë janë marrë parasysh me rastin e marrjes së vendimeve për caktimin e rasteve prioritare? Kush i ka marrë ato vendime? A është dokumentuar kjo në ndonjë mënyrë? Nëse po, ju lutemi që të na siguronit privat dokumentare.

PANELI ME RESPEKT KËRKON NGA MISIONI që të raportojë pas zbatimit të këtyre rekomandimeve dhe të përgjigjet në pyetjet e Panelit sa më parë që është e mundur për Misionin, por jo pas datës 15 prill 2020.

Për Panelin:

Guénaél METTRAUX
Kryesues

Anna BEDNAREK
Anëtare



Anna AUTIO
Anëtare